

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6231  
E enjte, 4 shkurt 2021  
çmimi 0.40 €

Zaret u hodhën,  
kush do të mbytet  
dhe përmbytet më  
14 shkurt 2021 | FAQE 10

Behxhet  
Sh. SHALA -  
BAJGORA



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

SUBJEKTET POLITIKE E KANË FILLUAR FUSHATËN PËR ZGJEDHJET  
E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 14 SHKURTIT | FAQE 4-5

## ME PREMTIME TË MËDHA E ME SHKELJE TË MASAVE FILLON FUSHATA ZGJEDHORE



Kandidatët e partive politike për kryeministër në ditën e parë të fushatës zgjedhore kanë shpallur programet e tyre. Albin Kurti, Enver Hoxhaj dhe Avdullah Hoti në adresimet e tyre kanë thënë se prioritetet e tyre do të jenë

luftimi i pandemisë dhe rimëkëmbja e ekonomisë. Në hapje të fushatës zgjedhore të mërkurën ata kanë premtuar rritje të pagës minimale, sigurime shëndetësore, sigurim të vaksinës kundër Covidit, mbështetje

për bizneset dhe veting në drejtësi. Në asnjë tubim të partive politike nuk janë respektuar masat kundër Covidit. Në çdo aktivitet janë parë grumbuj njerëzish pa mbajtur maskë dhe pa distancë fizike

## MBI 1 600 ANKESA E DHJETËRA POLICË TË SUSPENDUAR GJATË PANDEMISË | FAQE 7



Gjatë vitit 2020 janë arrestuar 32 punonjës policorë të dyshuar për vepra penale, ndërkaq janë suspenduar 83 të tjerë. Kështu ka thënë zëdhënësi i Inspektoratit Policor i Kosovës, Arbër Beka. Në bazë të statistikave të Inspektoratit Policor të

Kosovës, po ashtu gjatë vitit 2020, është shënuar rritje e numrit të ankesave të qytetarëve ndaj pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, me pretendimet se ata kanë bërë shkelje disiplinore ose janë përfshirë në vepra penale

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### OPINION

RRËNJËT E KONFLIKTIT  
AKTUAL SOCIAL, KUSH  
HUMB E KUSH FITON | F. 11

Milazim  
KRASNIQI



### AKTUALE



TRI VIKTIMA DHE 341 RASTE TË  
REJA ME COVID NË KOSOVË | F. 3

EKONOMIA E BE-SË TKURRET  
6.4 PËR QIND NË VITIN 2020 | F. 8

### EKONOMI



GAP-i REKOMANDON  
POLITIKA PËR PENSIONIM  
TË PARAKOHSHËM  
TË SHËRBYESVE CIVILË | F. 8

MINISTRI NITAJ ZOTOHET  
PËR INVESTIME NË FUSHËN  
E MJEDISIT NË GJAKOVË | F. 9

### SPORT

FILMI 'ZGJOI' I BLERTA  
BASHOLLIT FITON TRI ÇMIMET  
KRYESORE NË 'SUNDANCE' | F. 12

## Bideni ndryshon disa politika të migracionit

UASHINGTON, 3 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, po vazhdon zhbërjen e disa prej politikave të paraardhësit të tij, Donald Trump. Më 2 shkurt, Bideni ndryshoi disa politika të migracionit, duke krijuar një grup pune që do të merret me bashkimin e familjeve të migrantëve dhe duke urdhëruar rishikim të procesit të azilit në kufirin ShBA - Meksikë. Ndarja e fëmijëve nga prindërit e tyre, që filloi në

vitin 2018 si pjesë e strategjisë së Trumpit "tolerancë zero", ishte një nga politikat më të diskutueshme të administratës së tij. Trumpi e kishte mbrojtur këtë politikë si të nevojshme me qëllim që ta dekurajojë migracionin e paligjshëm dhe "për ta mbrojtur sigurinë kombëtare". "Ne do të punojmë për ta zhbërë turpin moral dhe kombëtar të administratës së mëparshme që fjalë për fjalë, jo në mënyrë figurative, rrëmbeu fëmijët nga krahët e




familjeve të tyre", tha Biden, ndërsa nënshkroi urdhrin ekzekutiv në Shtëpinë e Bardhë.

Bideni u zotua gjatë fushatës së tij zgjedhore në vitin 2020 për të lëvizur shpejt për t'i bashkuar prindërit dhe fëmijët e ndarë në kufirin jugor.

Më shumë se 600 fëmijë mbeten të ndarë nga prindërit, sipas një regjistrimi në janar të cituar nga mediat amerikane. Fëmijët po jetojnë me të afërmit ose në strehimore.

## Ekipi i OBSH-së inspekton një laborator të Vuhanit

VUHAN, 3 SHKURT - Ekspertët e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) e kanë vizituar një laborator në Vuhan të Kinës për të cilin ka pasur pretendime se nga aty ka dalë koronavirusi i ri. Inspektimi i Institutit të Virologjisë në Vuhan, në të cilin kryhen hulumtime mbi sëmundjet më të rrezikshme në botë, do të jetë një nga ndalesat në hetimet për origjinën e pandemisë Covid-19. Misionin e ekspertëve të OBSH-së, Kina e kishte vonuar gjatë gjithë vitit të parë të pandemisë. Ky ekip e ka për detyrë të shpjegojë se si



kërceu virusi nga kafshët të njerëzimit. Por, ka pikëpyetje për faktet që mund të gjejnë ata,

pasi ka kaluar shumë kohë që nga fillimi i pandemisë. "Ne po presim me padurim të

takohemi me të gjithë njerëzit kryesorë këtu dhe të bëjmë të gjitha pyetjet e rëndësishme që duhet të bëhen", ka thënë anëtari i ekipit Peter Daszak, sipas një video të transmetuesit japonez TBS. Shumica e shkencëtarëve mendojnë se Covid-19, i cili u shfaq për herë të parë në Vuhan dhe që ka vrarë më shumë se dy milionë njerëz në të gjithë botën, ka origjinën nga lakuriqët e natës dhe mund t'u transmetohej njerëzve përmes një gjitari tjetër. Ekspertët e OBSH-së qëndruan

brenda institutit për gati katër orë përpara se të largoheshin pa u ndalur për të folur me mediat që prisnin jashtë.

Kishte spekulime në fillim të pandemisë që virusi mund të kishte dalë aksidentalisht nga laboratori i biosigurisë në Vuhan, megjithëse nuk kishte prova për të mbështetur atë teori. Kina e ka mohuar atë mundësi dhe ka folur për teori të pabazuara se virusi mund ta ketë origjinën diku tjetër ose është sjell në vend me importet e prodhimeve të detit të ngrirë. Teoritë janë refuzuar nga shkencëtarët ndërkombëtarë.

## ShBA-ja i shpall ngjarjet në Burma si puç

UASHINGTON, 3 SHKURT - Departamenti amerikan i Shtetit ka shpallur veprimet e fundit të ushtrisë së Burmas si puç, dhe ka thënë se do ta rishikojë ndihmën që ndan për këtë shtet. Një zyrtar i Departamentit të Shtetit, ka thënë më 2 shkurt se Shtetet e Bashkuara do t'i mbajnë atje programet humanitare, mirëpo edhe do ta "rishikojnë ndihmën" ndaj Burmas, që njihet edhe si Mianmar. Uashingtoni ka kontribuar me 1.5 miliard dollarë në Burma prej vitit 2012, si mbështetje ndaj demokracisë, paqes së brendshme dhe komuniteteve më të prekura nga dhuna, sipas

të dhënave të Departamentit të Shtetit. Administrata amerikane është përmbajtur nga klasifikimi i ngjarjeve që kanë nisur në fundjavë në Mianmar, duke përfshirë ndalimin e lideres de fakto të këtij vendi, Aung San Suu Kyi. Këto ngjarje në Mianmar janë rezultat i tensioneve në rritje në mes të qeverisë dhe liderëve ushtarakë për rezultatin e zgjedhjeve të nëntorit të vitit të kaluar, meqë ushtria pretendon se rezultati është manipuluar. Presidenti amerikan, Joe Biden ka thënë më 1 shkurt se veprimi ushtarak është sulm ndaj demokracisë dhe sundimit të ligjit atje.



## Danimarka planifikon krijimin e pasaportës digjitale për të vaksinuarit kundër Covidit



Kopenhagë, 3 shkurt - Danimarka do të zhvillojë për herë të parë një pasaportë digjitale që dëshmon se personat që janë vaksinuar kundër koronavirusit, duke u mundësuar udhëtimet dhe ndihmuar lehtësimin të masave. Ministri i Financave, Morten Bedskov, ka thënë se gjatë një konferencë për media, se për tre

ose katër muaj pasaporta digjitale do të jetë e gatshme për përdorim, për shembull, për udhëtime zyrtare. "Ka rëndësi të madhe për ne që të mundemi sërish të vëmë në lëvizje shoqërinë daneze, me qëllim që kompanitë të rikthehen në binarë. Shumë kompani daneze janë kompani globale të cilat kanë bashkëpunim me tërë

botën. Do të jetë një pasaportë shtesë që do të mund ta keni në telefonin e juaj mobil që dokumenton nëse jeni vaksinuar", ka shtuar Bedskov. Pritet që në fund të shkurtit, qytetarët e Danimarkës do të mundeshin që në uebfaqen e Shëndetësisë ta shohin konfirmimin zyrtar si dhe nëse janë vaksinuar.

# Rrënjët e konfliktit aktual social, kush humb e kush fiton



Milazim KRASNIQI

Strukturat shoqërore në Kosovë janë heterogjene dhe të konfrontuara. Prandaj konflikti në shoqëri është permanent, si në fushatë, si jashtë saj. Por, në fushatë egërsohet më shumë. Në fushatën e fundit dallohen disa struktura si më të konfrontuara.

1. Rinia e papunë dhe e pashpresë, e cila është e mbyllur në Kosovë si në kafaz, e cila ka marrë arsim të dobët dhe e cila është e injoruar edhe nga elita politike. Ky grup social ka filluar të formësojë njëfarë identiteti dhe njëfarë kompaktësimi nëpërmjet rrjeteve sociale, pra identitet virtual, por në jetën reale të lidhur me fanatizëm me LV-në. Me idealizmin naiv, me konfuzionin psikologjik e politik, por pa ide e pa vizion të qartë, ky grupim vetëm do të

shfrytëzohet në lojën politike, siç janë shfrytëzuar para tij edhe disa breza të rinjsh, që mandej janë lënë anash. Por, tash për tash ata janë promotorët e idesë së ndryshimit.

2. Diaspora po shndërrohet në grupin social bukur konfliktual dhe me pasion hakmarrës në këtë fushatë. E drejta, në këto njëzet vjet, diaspora ka qenë e injoruar nga të gjitha qeveritë, që kanë defiluar e veçmas në vitet e para të çlirimit, nën UNMIK-un, kur nuk u jepeshin as letërnjoftime e pasaporta dhe kur gjysmën e pushime vjetore e kalonin në sportele të komunave për një dokument. Vit pas viti ata janë mbushur me pakënaqësi, por e keqja është që ka kohë që janë mbushur edhe me shumë urrejtje. Kartoni i gjelbër dhe pritjet e gjata në kufi, janë simbole të vrerit të tyre kundër qeverive të deritashme. Përkrahja e tyre masive për LV-në, i cili ligjërisht është legjitim, mund të krijojë në të ardhmen perceptime negative për rolin e tyre, gjë që do të ishte e dëmshme për ta e për gjithë shoqërinë tonë. Por, kjo mbetet të shihet në të

ardhmen.

3. Shërbyesit civilë, shumica e të cilëve janë rekrutuar me meritokraci partiake, nga LDK, PDK, AAK, Nisma dhe AKR, ku ka me mijëra që janë me kontrata mbi vepër, tash ndihen të rrezikuar nga ndryshimi, sepse mund të humbin vendet e punës. Logjikisht, ndryshimi do të godasë së pari në administratë, sepse aty mund të gjenerohen vende të punës për militantët e rinj, duke përjashtuar tepricën dhe ata që kanë kontrata të përkohshme. Prandaj, shumica e tyre duket se mbeten në istikamet e vjetra partiake, sigurisht me dezertime të një pjese të saj, e cila më nuk pret favore nga ish favorizuesit e vet. Shpreson të përfitojë ndonjë gjë më shumë edhe nga ndryshimi, meqë është mësuar të përfitojë, zakonisht pa merita.

4. Veteranët, invalidët dhe familjet e dëshmorëve duket se ndihen të shqetësuara nga ndonjë ndryshim i politikave sociale, nga një qeveri e diskontinuitetit. Prandaj me shumicë mbeten në krahun politik që identifikohet me

trashëgiminë e luftës.

5. Tash për tash grupi social më indiferent duken fshatarët, veçmas ata që nuk e punojnë tokën, veçse jetojnë nga remitancat që u dërgohen nga diaspora. Ata mund të votojnë me shumicë nën ndikimin e diasporës, nën ndikimin e saj, ndonëse realisht interesat e tyre dhe të diasporës janë të kundërvëna. Diaspora është kundër parazitizmit, ndërsa ky grupim i madh fshatarësh, janë për ta vazhduar këtë lloj parazitizmi, duke jetuar nga paratë që ua dërgojnë familjarët nga diaspora. Prandaj ata duken si grupim i hutuar, duan të bëhen me të renë, por pa hequr dorë nga e vjetra.

6. Intelektualët janë grupim i heshtur dhe gati inekzistentë. Natyrisht kjo ka efekte elektorale më pak, por ka efektet më të rënda morale, sepse e zbulon një gjendje të rëndë të krizës në tërë shoqërinë tonë.

7. Biznesmenët janë grupimi më kameleonik, ashtu që ata lëvizin nga njëri pol në tjetrin, shumë herë edhe në dëm të vetin. Fjala vjen, nëse përkrahin ndonjë parti me

program të majtë, ata mund të kenë probleme serioze në vitet që vijnë, me rritje tatimesh dhe me dekurajimin e investimeve, nga politikat e majta që zakonisht janë restriktive.

Si përfundim, epilogu i kësaj gare elektorale do të dalë nga rivaliteti ndërmjet rinisë së papunë, diasporës dhe një grupimi të fshatarëve në njërin anë dhe administratës, trashëgimisë së luftës çlirimtare dhe fshatarëve më shpianikë, në anën tjetër. Përparësia fillestare është në anën e partisë që është e njohur për nxitjen dhe sforcimin e konflikteve politike dhe sociale, pra, LV-së. Mbetet të shihen kundërpërgjigjet e PDK-së dhe LDK-së, të cilat komoditeti në qeverisje i ka bërë të pandjeshme ndaj grupeve të pakënaqura. AAK-ja me narracionin për bashkimin kombëtar, të cilin askush nuk e beson si të mundshëm në këtë fazë, dhe Nisma më narracionin për çlirimtarët, si pronësi e saj, të cilën shumica nuk beson si të vërtetë, janë jashtë kësaj skeme të luftës elektorale të grupeve të mëdha sociale, që sapo ka filluar zyrtarisht.

## Tri viktimat dhe 341 raste të reja me Covid në Kosovë

**EPOKA ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 SHKURT - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 2 357 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 341 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar tri raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Pejë një rast (75 vjeç), Suharekë një rast (40 vjeç) dhe Vushtrri një rast (90 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 61 086 raste nga 240 696 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 509 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 207 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 53 017 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 560.



Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 113 raste, Prizren 57 raste, Podujevë 21 raste, Vushtrri 14 raste, Gjiilan 13

raste, Lipjan 13 raste, Ferizaj 12 raste, Pejë 12 raste, Gjakovë 11 raste, Mitrovicë 11 raste, Suharekë 10 raste, Fushë-Kosovë

9 raste, Malishevë 9 raste, Skenderaj 7 raste, Klinë 5 raste, Viti 5 raste, Drenas 4 raste, Obiliq 3 raste, Rahovec 3 raste, Dragash

2 raste, Istog 2 raste, Kamenicë 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë, Shtime dhe Shtërpçë 1 rast.



SUBJEKTET POLITIKE E KANË FILLUAR FUSHATËN PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 14 SHKURTIT

## Me premtime të mëdha e me shkelje të masave fillon fushata zgjedhore

Kandidatët e partive politike për kryeministër në ditën e parë të fushatës zgjedhore kanë shpalosur programet e tyre. Albin Kurti, Enver Hoxhaj dhe Avdullah Hoti në adresimet e tyre kanë thënë se prioritetet e tyre do të jenë luftimi i pandemisë dhe rimëkëmbja e ekonomisë. Në hapje të fushatës zgjedhore të mërkurën ata kanë premtuar rritje të pagës minimale, sigurime shëndetësore, sigurim të vaksinës kundër Covidit, mbështetje për bizneset dhe veting në drejtësi. Në asnjë tubim të partive politike nuk janë respektuar masat kundër Covidit. Në çdo aktivitet janë parë grumbuj njerëzish duke mos mbajtur maska dhe distancë



Lideri i LV-së ka premtuar se për çiftet e reja dhe gratë kryefamiljare do t'u mundësojë banim të përballeshëm për 4 000 familje. "Para të gjitha familjeve dhe prindërve, zotohem se do të punoj për t'i mbështetur për sigurimin e banimit të përballeshëm për çdo kategori të shoqërisë. Për çiftet e reja, gratë kryefamiljare, por edhe shërbyesit publikë, vetëm gjatë mandatit të parë të qeverisjes do të mundësojmë banim të përballeshëm për 4 000 familje", është shprehur ai.

### Hoxhaj iu premtonte bizneseve lehtësira fiskale dhe përkrahje përmes granteve investive

Në ditën e parë të fushatës, kandidati i PDK-së për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka mbajtur një takim me përfaqësues të bizneseve në Prizren. Me këtë rast, ai ka thënë se plani i rimëkëmbjes ekonomike parasheh lehtësira fiskale, përkrahje direkte përmes granteve investive dhe subvencioneve. "Plani i

Rimëkëmbjes është plan për zhvillimin e bizneseve. Është plan për rritjen e punësimit dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve tanë. Para shumë biznesmenëve prizrenas dje prezantova Planin e Rimëkëmbjes, i cili parasheh fondin prej 1 miliard eurosh për rimëkëmbjen ekonomike, ku 500 milionë euro do të jenë të dedikuara vetëm për bizneset. Prizreni është qendër e kulturës dhe historisë sonë. Por, ndër vendimet e para që do të marr si kryeministër, do të jetë vendimi për ta bërë Prizrenin edhe zonë

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 3 SHKURT** - Subjektet politike kanë filluar fushatën zgjedhore me premtime të mëdha. Subjektet politike që do të garojnë në zgjedhjet e parakohshme të 14 shkurtit, në ditën e parë të fushatës kanë mbajtur nga disa tubime, ku kandidatët e tyre për kryeministër kanë prezantuar programet e tyre qeverisëse. Në asnjë prej këtyre tubimeve nuk janë respektuar masat kundër Covidit.

Kandidati për kryeministër i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka qenë i pari që ka paraqitur programin qeverisëse dhe kandidatët për deputetë për zgjedhjet e 14 shkurtit. Përmes një adresimi në profilin e tij në "Facebook", ai ka thënë se prioriteti i qeverisjes së tij do të jetë luftimi i pandemisë, duke premtuar vaksinimin e më shumë të 60 për qind të popullatës me vaksinën kundër Covid-19. "Masat e veprimit të menjëhershëm do të jenë: vaksinimi i së paku 60 për qind të popullatës, sigurimi

i qëndrueshëm të barnave dhe testeve, trajnimi i vazhdueshëm i stafit shëndetësor, komunikimi transparent dhe i dendur me qytetarët. Krejt bashkë ecim drejt 14 shkurtit. Sfidat e madhe, por vullneti është më i madh", ka thënë Kurti, duke shtuar se synim tjetër është rimëkëmbja e ekonomisë. "Duam ta nxjerrim Kosovën nga kriza e shumëfishtë. Ka rënie në ekonomi, vende të humbura të punës, kthimi i jetës në normalitet është prioriteti ynë në vitin e parë të qeverisjes. Synojmë një ekonomi që del nga pandemia e shëruar edhe nga shumë sëmundje të tjera që e kanë përcjell deri tani", ka thënë Kurti.

Më tej, ai ka përmendur Fondin Sovran e Bankën Zhvillimore për rritjen e investimeve. "Do të krijojmë Fondin Sovran dhe Bankën Zhvillimore të Kosovës. Fondi Sovran do t'i marrë në pronësi asetet strategjike të Kosovës dhe do ta ketë përgjegjësinë për investime në rritjen e vlerës së tyre", është shprehur ai.



ekonomike”, ka thënë Hoxhaj. Ndërsa tubimin qendror hapës kjo parti e ka mbajtur në mbrëmje në Komunën e Skenderajt. Në këtë tubim është bërë prezantimi i programit qeverisës dhe i kandidatëve për deputetë nga radhët e PDK-së.

### Hoti premtor pagë minimale 300 euro dhe sigurime shëndetësore

Edhe kandidati i LDK-së për kryeministër, Avdullah Hoti, ka prezantuar prioritetet e tij në ditën e parë të fushatës. Përmes një videomesazhi të publikuar në profilin e tij në “Facebook”, ai është shprehur i bindur se do të fitojë zgjedhjet e 14 shkurtit. Me këtë rast, ai ka premtuar rritje të pagës minimale, sigurime shëndetësore e veting në drejtësi. Ai ka thënë se prioritet i tij i parë do të jetë shëndetësia, duke thënë se do të punojë për vaksinim. “Ne zotohemi për investime në fuqizimin e rinisë, punë praktike me pagesë, grante për biznese për të rinj, bursa për talente, njohje të punës

procedura transparente. Do t'i rrisim sipërfaqet bujqësore nën ujë. Do ta përmbyllim rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm për të gjithë qytetarët dhe trajtimin e ujërave të zeza. Zotohemi t'oj digjitalizojmë të gjitha shërbimet publike në afat rekord, që të evitojmë çdo burokraci ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Do t'i digjitalizojmë shkollat tona dhe do të mbështesim bizneset inovative. Prokurimi publik do të jetë plotësisht elektronik, transparent dhe me standarde të reja, ku shpërblehen firmat që punojnë, që respektojnë kontratat që kryejnë punët me cilësi. Odat dhe shoqatat profesionale do të marrin rol me ligj në zbatimin e politikave ekonomike dhe sociale”, është shprehur Hoti, duke paralajmëruar rritje të pagës minimale në 300 euro.

### Haradinaj: Zgjedhjet do të jenë dështim nëse nuk e zgjedhim presidentin

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) hapjen e



Prizrenin e Kosovën. Më 14 shkurt, kur votojmë, sukcesi i këtyre nuk do të varet vetëm nga zgjedhja e Kuvendit, por edhe zgjedhja e presidentit. Nëse nuk e zgjedhim presidentin, këto zgjedhje do të jenë dështim”, ka thënë Haradinaj.

### Limaj: Nisma do të jetë befasia më e madhe e këtyre zgjedhjeve

Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, në tubimin hapës zgjedhor, ka thënë se sot më shumë se kurrë Kosovës i duhet zëri dhe fryma çlirimtare. Ai ka deklaruar se zëri i atdheut i thërret përsëri të rreshtohemi rreth brigadës 121. “Nga Avniu, dëshmorit më i ri i brigadës e deri te më i vjetri që e kam vizituar dje, ne arritëm të dalim faqebardhë, ne mbrojtëm kauzën e shenjtë të lirisë së Kosovës, ne mbrojtëm mbi 85 mijë njerëz të cilët në atë kohë e kishin vënë fatin e tyre në dorë të djemve të UÇK-së. Ata na besuan krejt çka kishin, duke qenë të bindur se nuk dezertojmë. Ne jemi simbol i

mbrojtës, i sakrificës dhe jemi simbol i lirisë dhe fitoreve. Ne jemi brigada 121”, ka thënë Limaj.

Ai ka thënë se të gjithë duhet të bashkohen rreth frymës çlirimtare. “Sot, më shumë se kurrë, Kosova ka nevojë për zërin çlirimtar në Kuvendin e Kosovës. Ne asnjëherë deri më tani nuk kemi bërë kompromis me interesa të atdheut. Sot po iu drejtohem bashkëlufetarëve të mi anekënd Kosovës, sepse më shumë se kurrë kemi nevojë të bashkohemi në këtë frymë çlirimtare. Po u drejtohem familjeve patriotike që kanë dhënë gjithçka për të ardhur këtu. Rreshtohuni e bashkohuni me këtë frymë çlirimtare”, ka thënë kryetari Limaj, duke shtuar se kjo parti do të jetë befasia më e madhe e këtyre zgjedhjeve. “Do ta shihni më 14 shkurt. Qindra mijëra qytetarë që nuk kanë qenë me Nismën po rreshtohen e po i bashkohen kësaj kauze dhe po e shohin këtë projekt si mbipartiak”, është shprehur ai. Kurse sekretari i përgjithshëm i Nismës, Bilal Sherifi, i cili ka shpalosur shtyllat e programit për zgjedhjet e 14 shkurtit, ka

thënë se kjo parti do të bëjë më të mirën për shëndetësinë, bujqësinë, ekonominë, arsimin, politikën sociale, për rininë dhe për punësimin e tyre. Po ashtu, sekretari Sherifi ka folur edhe për mbështetjen që kauza e tyre do të bëjë për veteranët. “Ne jo vetëm që do t'u japim zë veteranëve, por ne do t'i lejojmë me ligj që të gjithë veteranët që marrin mbështetje financiare, të kenë edhe të drejtë pune qoftë në sektorin privat apo në administratë”, ka thënë ai.

### Masat kundër Covid nuk respektohen nga partitë politike

Në ditën e parë të fushatës zgjedhore partitë politike kanë vazhduar t'i shkelin masat kundër Covidit ashtu siç kanë bërë në periudhën e parafushatës. Në çdo aktivitet janë parë grumbuj njerëzish, duke mos mbajtur maska dhe distancë. Një ditë me parë disa organizata të shoqërisë civile kanë ftuar partitë politike që gjatë fushës zgjedhore t'i respektojnë masat kundër Covidit.

Të njëjtën gjë e ka kërkuar edhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKShPK). IKShPK-ja përmes një komunikate ka bërë pesë rekomandime për partitë politike gjatë fushatës. Në pikën e tretë, IKShPK-ja ka rekomanduar ndalimin rigoroz të tubimeve. “Grumbullimi i qytetarëve pa maska dhe pa mbajtje të distancës shton rrezikun e përhapjes së infeksionit, përderisa virusi SARS-COV-2 është në mesin tonë. U bëjmë thirrje institucioneve përgjegjëse, përkatësisht Policisë së Kosovës dhe inspektoratëve përgjegjëse, të mbikëqyrin në përpikëri dhe t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave dhe vendimeve të tjera në fuqi për zbatim të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në Republikën e Kosovës”, është thënë në komunikatën e IKShPK-së.



vullnetare. Ne duam që të gjithë t'i shohin bukuritë dhe begatitë që ka Kosova. Do ta zhvillojmë turizmin, t'i pavarësojmë institucionet e kulturës, t'i mbështesim artistët dhe ngjarjet kulturore”, ka thënë ai. Hoti ka premtuar lehtësime për kushte të kredivë, subvencionime të normave të interesit, grante për biznese, fiskalizim digjital dhe liberalizim të tregut të energjisë. “Do ta mbështesim bujkun dhe prodhuesin me shumë më tepër subvencione dhe grante, të orientuara kah prodhimi, me

fushatës e ka bërë në Prizren. Në këtë tubim, kandidati i kësaj partie për president, Ramush Haradinaj, ka thënë se nëse nga zgjedhjet e 14 shkurtit nuk arrihet të dilem me një emër për president të Kosovës, zgjedhjet do të jenë dështim. “Një ide themel vazhdon të jetë e jona se ne dëshirojmë të jetojmë në paqe me fqinjët tanë. Prizreni është një qytet që na nderon, pra qytet i vlerave kulturore, fetare e trashëgimisë. Prizreni ka sfidat e veta, i mungon hekurudha dhe lidhja me Tetovën. Do të jemi bashkë për



## Filmi 'Zgjoji' nga Blerta Basholli fiton tri çmimet kryesore në 'Sundance'

PRISHTINË, 3 SHKURT (ER) - Filmi artistik nga Kosova, "Zgjoji", me regji nga Blerta Basholli, bëri historinë duke marrë tri çmimet kryesore të Sundance Film Festival: Filmi më i mirë, Regjisorja më e mirë; dhe Çmimi i vlefshëm të publikut të festivalit më të madh të filmit të pavarur në ShBA. "Të shpërblehem nga festivali im i

preferuar, ka rëndësi të papërshkrueshme për mua. Dua t'i ndaj këto çmime me të gjithë ekipin, aktorët dhe posaçërisht me Fahrije Hotin të cilën e mbaj në zemër që nga momenti i parë që e kam takuar, dhe e cila është shembull për të gjithë ne", u shpreh Blerta përmes një videomesazhi me rastin e

pranimit të çmimit Regjisorja më e mirë gjatë ceremonisë së ndarjes çmimeve. "Kemi punuar shumë dhe gjatë që ta sjellim këtë film para jush, publikut, dhe jemi shumë të nderuar që na shpërblyet. Duam t'ia dedikojmë këtë çmim vendit tonë të dashur dhe të bukur, Kosovës", u shpreh Yll Uka, producenti i

filmit me rastin e pranimit të çmimit të Publikut dhe çmimit Filmi më i mirë (Grand Jury Prize).

"Zgjoji" është i frymëzuar nga historia e vërtetë e Fahrijes (interpretuar nga Yllka Gashi) nga Krusha e Madhe, e cila në kërkim të burrit të humbur gjatë luftës në Kosovë, fillon një biznes bujqësor për ta siguruar

mbijetesën e familjes, në një ambient tradicionalisht patriarkal, ku ambicia për t'u zhvilluar nuk shihet me sy të mirë.

Në rolin kryesor luan Yllka Gashi, ndërsa në rolet e tjera luajnë Çun Lajçi, Kumrije Hoxha, Aurita Agushi, Kaona Sylejmani, Mal Noah Safçiu, Adriana Matoshi, Astri Kabashi, Molikë Maxhuni, Blerta Ismaili, Valire Haxhijaj Zeneli, Armend Smajli, Ilir Prapashtica, Xhejlane Terbutja, Shkelqim Islami etj; me producent Yll Ukën, drejtor fotografie Alex Bloom, montazher Enis Saraçi dhe Félix Sandri, dhe me bashkëproducentë Valon Bajgorën, Agon Ukën, Britta Rindelaubin, Kristijan Burovskin, Tomi Salkovskin, dhe Paskal Seminin.

"Zgjoji" është bashkëprodhim filmik në mes të Kosovës, Zvicrës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, mbështetur nga Qendra Kinematografike e Kosovës, Zyra Federale për Kulturë FOC dhe Cineforum (Zvicër), Agjencia e Filmit e Maqedonisë së Veriut dhe Qendra Kombëtare për Kinematografi (Shqipëri), prodhuar nga "Ikonë Studio" dhe "Industria Film", me bashkëprodhim nga "Alva Film Production", "Black Cat Production", "AlbaSky", "Swiss National TV", ndërsa të drejtat e shitjes globale i ka LevelK.



SUNDANCE FILM FESTIVAL 2021

## Miratohet lista e veçantë e pronave të paluajtshme të Komunës së Podujevës për dhënie në shfrytëzim

PODUJEVË, 3 SHKURT (ER) - Kuvendi i Komunës së Podujevës ka mbajtur mbledhjen e rregullt të cilën e ka udhëhequr kryesuesi Fatmir Gashi, e ku ishte i pranishëm edhe kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi dhe drejtorët e drejtorive. Fillimisht në këtë mbledhje kanë dhënë betimin solemn dy këshilltarët e rinj të Kuvendit, Haki Rudari dhe Ragip Fetahu nga LV-ja, të cilët kanë marrë mandatin në vend të Bajram Ajetit dhe Vendenis Lahut nga ky subjekt politik, të



cilët kanë dorëzuar mandatin e këshilltarit. Po ashtu, këshilltari Benjamin Ejupi ka njoftuar Kuvendin se tash e tutje do të jetë pjesë e grupit të këshilltarëve të LV-së.

Drejtori i Arsimit, Avni Fetahu dhe drejtori i Administratës, Bahri Selimi, kanë paraqitur nga një informatë të përgjithshme për punën e këtyre drejtorive. Pas dhënies së dorëheqjes së Vendenis Lahut nga pozita e këshilltarit komunal, i cili ishte edhe anëtar i Komitetit për Politikë

dhe Financa, Kuvendi miratoi vendimin që vendin e lirë ta plotësojë me këshilltarin Florent Hasani nga LV-ja.

Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur të mërkurën, ka miratuar vendimin për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2021 dhe ka marrë vendime dhe ka shqyrtuar edhe disa çështje të tjera me interes për qytetarët.

## Zemaj e Rugova nënshkruajnë marrëveshje për ndërtimin e QKMF-së në Istog

Istog, 3 shkurt (ER) - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj dhe kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, kanë nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit për financimin e projektit për ndërtimin e QKMF-së në këtë qytet. "Qytetarët e Komunës

së Istogut meritojnë gjithë kujdesin e institucioneve shëndetësore për kualitet të shërbimeve, me personel dhe ambiente cilësore. Ministria e Shëndetësisë nga buxheti i saj financon projektin me 2,500,000 euro. Qeverisja jonë, përkushtimi për

qytetarët dhe shtetin, nuk është fjalë apo parullë e fushatave, është punë e detyrim yni ditor, angazhim yni i qëndrueshëm, i dëshmuar dhe vlerësuar, si dje, si sot, si nesër!", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".



# Mbi 1 600 ankesa e dhjetëra policë të suspenduar gjatë pandemisë



PRISHTINË, 3 SHKURT - Gjatë vitit 2020 janë arrestuar 32 punonjës policorë të dyshuar për vepra penale, ndërkaq janë suspenduar 83 të tjerë. Kështu ka thënë zëdhënësi i Inspektoratit Policor të Kosovës, Arbër Beka. Në bazë të statistikave të Inspektoratit Policor të Kosovës, po ashtu gjatë vitit 2020, është shënuar një rritje e numrit të ankesave të qytetarëve ndaj pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, me pretendimet se ata kanë bërë shkelje disiplinore ose janë përfshirë në vepra penale.

Nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë vlerësojnë se ankesat e shtuara nga ana e qytetarëve të Kosovës ndaj pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, janë pasojë e rrethanave të jashtëzakonshme të krijuara nga pandemia e koronavirusit.

Zëdhënësi i Inspektoratit Policor të Kosovës, Arbër Beka, ka pohuar për "Radion Evropa e Lirë" që gjatë vitit 2020, ky Inspektorat ka pranuar dhe administruar gjithsej 1 658 ankesa, prej të cilave 17 informata, që nënkupton se numri i ankesave ka qenë 15 për qind më shumë sesa në vitin paraprak.

Sipas Bekës, 1 071 ankesa apo 64.60 për qind e numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar në këtë Inspektorat janë kualifikuar se përmbajnë elemente të përfshirjes së punonjësve policorë në shkelje disiplinore.

Të njëjtat, siç thotë Beka, janë proceduar në Divizionin e Hetimeve të Brendshme dhe Verifikimin e të Kaluarës në kuadër të Policisë së Kosovës.

Pjesa tjetër, 574 ankesa, janë kualifikuar si ankesa që përmbajnë elemente të përfshirjes së punonjësve policorë në vepra penale. Këto ankesa, siç bën me dije, janë proceduar në Departamentin e Hetimeve të IPK-së për trajtim e hetim të mëtejshëm.

"Inspektorati Policor i Kosovës vitin e kaluar ka proceduar me kallëzim penal në Prokurorinë e Shtetit gjithsej 82 raste. Përveç kësaj, në kuadër të realizimit të objektivave ligjore gjatë vitit 2020 janë realizuar gjithsej 32 arrestime të punonjësve policorë të dyshuar për vepra penale, si dhe të gjashtë qytetarëve të dyshuar të cilët kanë qenë të përfshirë në veprimtari penale në rastet ku janë hetuar edhe punonjësit e policisë. Përveç tyre janë rekomanduar edhe 83 suspendime, si dhe një transferim i një zyrtari policor", ka theksuar Beka.

Ai ka shtuar se në kuadër të numrit të kallëzimeve penale ndaj zyrtarëve policorë janë të përfshira edhe rastet që nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ankesat e qytetarëve gjatë periudhës së pandemisë.

## Vrajolli: Ka pasur raste të përdorimit të tejkualuar të forcës

Mentor Vrajolli, drejtor ekzekutiv i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", konsideron se numri i shtuar i ankesave të qytetarëve ndaj zyrtarëve policorë, është rezultat i rregullave shtesë dhe kufizimeve të caktuara që janë

vënë në kuadër të masave të vendosura nga Qeveria e Kosovës, për ta menaxhuar pandeminë e koronavirusit. Sipas tij, në mjaft raste janë qytetarët që kanë shkelur këto masa për shkak se nuk kanë qenë mirë të definuara fillimisht e të cilat kanë hasur në reagimin e policisë. "Kemi edhe raste ku duket qartë se ka pasur tejkualim të përdorimit të forcës nga policia. Në fakt, Policia e Kosovës, sa i përket garantimit të sigurisë publike, ka një notë pozitive. Nuk mund të përgjithësohet ky numër i rasteve me punën e mirë që ka kryer policia në terren. Domsodo që kultura e përgjithshme shoqërore reflektohet edhe në polici dhe jo domosdo që të gjithë policët janë pjesë e shoqërisë, të cilët janë në gjendje ta kuptojnë mënyrën se si një polici moderne mund të veprojë. E mira është që institucionet tashmë kanë ngritur rastet kundër këtyre policëve", ka theksuar Vrajolli.

## Keqpërdorimi i autoritetet luhat besimin e qytetarëve

Disa qytetarë në Prishtinë vlerësojnë se zyrtarët e Policisë së Kosovës gjatë vitit të kaluar, sidomos prej kur janë shpallur masat qeveritare për luftë ndaj pandemisë së koronavirusit, në përgjithësi ka pasur sjellje korrekte. Por, megjithatë, ata kanë pikëpamje të ndryshme lidhur me rastet ku, siç thonë ata, policia dhe qytetarët kanë pasur "fërkime".

Vlera Haxhibeqiri, studente e

Fakultetit Juridik në Universitetin e Prishtinës, thotë se në Policia e Kosovës, si institucion, duhet të ketë kujdes që ta ruajë imazhin e saj pozitiv dhe të merituar përballë qytetarëve të vendit. "Deri më tash deri-diku kam qenë e kënaqur dhe e mburrur me Policinë e Kosovës, derisa i kam parë disa raste të pakëndshme të cilat më kanë bërë që të paragjykoj ose gjykoj më ndryshe këtë polici. Është gabim që të përdoret autoriteti për të keq. Policia e ka për detyrë që të mbrojë dhe të kujdeset për qytetarin. Kjo është detyra e saj. Pra, të shkruaj dënimin dhe jo të silllet keq ose të rrahë dikë sepse është keqpërdorim i detyrës", ka thënë Haxhibeqiri.

Bleon Uka, student i Infermierisë, thotë që në të shumtën e rasteve sjellja e zyrtarëve policorë ka qenë e mirë dhe korrekte me qytetarët. Por, sipas tij, përgjatë periudhës së pandemisë, janë shënuar edhe disa raste të cilat janë publikuar përmes mediave, ku policia nuk ka qenë në nivelin e detyrës. "Nuk duhet të përfshihet e gjithë Policia e Kosovës, por ka vetëm raste të policëve. Nuk është e drejtë të përdoret dhunë ndaj qytetarit. Ka pasur shumë raste të tilla për shkak të (mosvendosjes) së maskës", ka deklaruar Uka.

Por, zëdhënësi i Inspektoratit Policor i Kosovës, Arbër Beka, thotë se, përveç të tjerash, ankesat e parashtruara nga qytetarët për shkak të gjobave të shqiptuara nga ana e Policisë së Kosovës, duke shprehur mospajtime dhe ankesa të ndryshme për veprimet e

policisë, duhen parë si shenja pozitive. "Ka ngritje të besueshmërisë së qytetarëve tek Inspektorati Policor i Kosovës", ka theksuar Beka.

Ditë më parë Policia e Kosovës ka arrestuar një zyrtar policor i cili dyshohet se në vitin 2018 kishte keqtrajtuar fizikisht një 18-vjeçar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare brenda hapësirave të një stacioni policor në Prishtinë. Arrestimi i zyrtarit policor pasoi pas publikimit në media të një videoje, në bazë të së cilës dyshohet që zyrtari policor ka keqtrajtuar fizikisht të riun. Lidhur me rastin, janë suspenduar edhe dy zyrtarë të tjerë policorë.

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, në një takim me drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti dhe kryeshëfinit ekzekutiv të Inspektoratit të Policisë së Kosovës, Kushtrim Hodaj, më 1 shkurt, ka kërkuar që "t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme ndaj çdo zyrtari policor, i cili keqpërdor detyrën". Hoti ka kërkuar nga Inspektorati i Policisë së Kosovës që "t'i trajtojë me shumë përkushtim të gjitha ankesat e qytetarëve që vijnë në adresë të policisë, të jenë këmbëngulës dhe të pakompromis për respektimin e etikës dhe sjelljes profesionale të policisë". Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, që nga futja në fuqi e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e Covid-19, më 26 gusht të vitit 2020 e deri më 28 janar të vitit 2021, "janë shqiptuar 125 420 fletëparaqitje ndaj personave pa dallime, për moszbatim të masave ndaj pandemisë Covid-19".

# Kosova ka plotësuar të gjitha kushtet për Kartonin e Gjelbër, pengesë mosanëtarësimi në OKB

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, gjatë një vizite në Byronë Kosovare të Sigurimeve (BSK), ka thënë se Kosova i ka plotësuar të gjitha kushtet për anëtarësim për Kartonin e Gjelbër, mirëpo pengesë kryesore është mosanëtarësimi i vendit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB). Ndërkaq ushtruesi i detyrës së drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku, ka thënë se të hyrat në BKS kanë rënë për 65 për qind si pasojë e Covid-19



**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 3 SHKURT** - Kosova ka plotësuar të gjitha kushtet për anëtarësim për Kartonin e Gjelbër, mirëpo pengesë kryesore është mosanëtarësimi i vendit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Kështu ka thënë guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, në një vizitë në Byronë Kosovare të Sigurimeve (BKS), duke shtuar se është vërejtur përmirësim në sektorin e sigurimeve. "Vitet e fundit vërehet përmirësim i këtij sektori dhe masat e ndërmarra nga Banka Qendrore e Kosovës kanë qenë efektive në kufizimin e shpenzimeve, duke marrë parasysh rënien e konsiderueshme në sektorin e sigurimeve. Gjatë vitit 2020

kemi rënie të shpenzimeve me 13 për qind, nëse e krahasojmë brenda një viti", ka thënë Mehmeti. Sipas tij, ka pasur rënie të dëmeve të paguara brenda vitit të kaluar. "Dëmet e paguara bruto arritën diku 46 milionë euro apo një rënie e lehtë prej 4-përqindësh, që vjen nga aplikimi i masave kufizuese të lëvizjes në fillim të vitit të kaluar. Kemi një rënie të primeve, ku shuma e përgjithshme gjatë vitit 2020 ishte rreth 4 milionë euro, kurse pagesa e dëmeve arriti në 5.5 milionë euro", u shpreh ai. Mehmeti ka thënë se vazhdon të mbetet i lartë numri i automjeteve të pasiguruara që qarkullojnë nëpër rrugët e Kosovës. "Çështje tjetër janë mjetet e pasiguruara që qarkullojnë çdo ditë e më shumë dhe rrezikojnë jetën e

qytetarëve. Aksidentet me fatalitet në të shumtën e rasteve vijnë kryesisht nga këto automjete të pasiguruara", është shprehur Mehmeti. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku, ka thënë se për katër muaj prej është duke ushtruar këtë detyrë ka pasur angazhim në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me BKS-në. Ai ka thënë se shqetësues mbetet numri i madh i automjeteve të

paregjistruara. "Shqetësimi ynë mbetet numri i madh i automjeteve të pasiguruara", ka thënë Mazreku. Ai ka theksuar se BKS-ja që nga themelimi është përballur me sfidën më të madhe për shkak të Covid-19. "Unë jam në muajin e katërt të mandatit tim si ushtrues detyre i drejtorit të Byrosë së Sigurimeve. Gjatë kësaj kohe angazhimi im dhe i stafit tim ka qenë maksimal për ta menaxhuar BKS-në në kohën

më të vështirë që nga themelimi i BKS-së si pasojë e Covid-19. Të hyrat gjatë vitit që lamë pas kanë rënë në 65 për qind. Për ne kjo ka qenë sfiduese, por me një angazhim të madh deri këtu ia kemi dalë ta menaxhojmë situatën", ka thënë ai. Personat që hyjnë në Kosovë me autovetura duhet të paguajnë 15 euro për qëndrimin prej 15-ditësh, ndërkaq qëndrimi për një muaj kap vlerën e sigurimit prej 20 eurosh.

## GAP-i rekomandon politika për pensionim të parakohshëm të shërbyesve civilë

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 3 SHKURT** - Instituti për Studime të Avancuara (GAP) ka publikuar raportin që rekomandon politika. Sipas raportit të GAP-it, shërbyesit civilë përbëjnë 26.7 për qind të të gjithë të punësuarve në sektorin publik, e 7.9 për qind e tyre përbushin kushtin për pensionim të parakohshëm, pasi kanë kaluar moshën 63 vjeç. "Duke u bazuar në të dhënat e siguruar nga Thesari i Shtetit, del se shërbyesit civilë përbëjnë 26.7 për qind të të gjithë të punësuarve në sektorin publik. Moshë mesatare në shërbimin civil është 47.5 vjet. Nga numri i përgjithshëm i shërbyesve civilë, 14.1 për qind janë mbi moshën 60-vjeçare. Sipas Ligjit për Zyrarët Publikë, pensionimi i parakohshëm fillon nga moshë 63-vjeçare dhe mund të bëhet me kërkesë të shërbyesve civilë ose me vendim të institucionit.

Janë 1 091 shërbyes civilë që kanë arritur moshën 63-vjeçare (7.9 për qind e shërbyesve civilë)", thuhet në raportin e GAP. Ndryshe prej institucioneve qendrore e të pavarura, komunat kanë të punësuar më shumë shërbyes civilë mbi moshën 63-vjeçare. "Komunat kanë të punësuar më shumë shërbyes civilë mbi moshën 63-vjeçare sesa institucionet e nivelit qendror dhe institucionet e pavarura. Duke marrë parasysh se Kosova ka shkallën më të lartë në Evropë të të punësuarve në sektorin publik në krahasim me numrin e përgjithshëm të të punësuarve, Instituti GAP rekomandon politika të cilat inkurajojnë pensionimin e parakohshëm dhe moszëvendësimin e atyre pozitive me punonjës të rinj me qëllim të uljes së numrit të të punësuarve në sektorin publik dhe uljen e buxhetit shtetëror për paga dhe shtesa", thuhet në raportin e GAP-it.



# Ekonomia e BE-së tkurret me 6.4 për qind në vitin 2020

PRISHTINË, 3 SHKURT - Ekonomia e Bashkimit Evropian është tkurur me 6.4 për qind si pasojë e pandemisë Covid-19. Zyra Evropiane e Statistikave ka publikuar të dhënat paraprake lidhur me Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) për tremujorin e katërt të vitit 2020 për BE-në dhe Eurozonën. Sipas

kësaj, PBB-ja në Eurozonë në çerekun e fundit të vitit 2020 ka rënë me 0.7 për qind në krahasim me çerekun paraprak, ndërsa kjo shifër në krahasim me çerekun e fundit të vitit 2019 ra me 5.1 për qind.

Në BE, PBB-ja në tremujorin e katërt të vitit 2020, në krahasim me tremujorin paraprak, pësoi

rënie prej 0.5-përqindësh në krahasim me tremujorin e katërt të vitit 2019 ra me 4.8 për qind. Ekonomia e BE-së në vitin 2020 u tkurr për 6.4 për qind, ndërsa në Eurozonë për 6.8 për qind. PBB-ja, në tremujorin e katërt, në krahasim me atë të tretë, në Austri u tkurr për 4.3 për qind, në Itali 2 për qind, në Francë 1.3 për

qind, ndërsa në Gjermani u rrit për 0.1 për qind, Belgjikë për 0.2 për qind dhe Spanjë për 0.4 për qind.

Ndërkaq, PBB-ja në tremujorin e katërt në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në Spanjë u tkurr për 9.1 për qind, në Austri për 7.8 për qind, në Itali për 6.6 për qind, në Portugali për

5.9 për qind, Francë për 5 për qind, Belgjikë për 4.8 për qind dhe Gjermani për 3.9 për qind.

Në tremujorin e dytë ekonomia në BE ishte tkurur për 11.4 për qind, në Eurozonë për 11.7 për qind, ndërsa në tremujorin e tretë BE-ja kishte shënuar rritje prej 11.5-përqindësh dhe Eurozona për 12.4 për qind.



## Ministri Nitaj zotohet për investime në fushën e mjedisit në Gjakovë

PRISHTINË, 3 SHKURT (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Muharrem Nitaj, ka vizituar të mërkurën Komunën e Gjakovës, në të cilën është pritur nga kryetari i kësaj komune, Ardian Gjini. Gjatë vizitës në Komunën e Gjakovës, ministri Nitaj është njoftuar me projektet e përbashkëta që kanë MEA dhe Komuna e Gjakovës, me ç'rast kanë nënshkruar tri marrëveshje nga fusha e mbrojtjes së mjedisit dhe ambientit.

Ministri Nitaj ka thënë se vëmendja e ministrisë që ai drejton është e orientuar ta mbështesë Komunën e Gjakovës për realizimin e projekteve që për synim kanë mirëqenien e qytetarëve dhe këtë më së miri e dëshmon nënshkrimi i këtyre



marrëveshjeve. "Të gjitha marrëveshjet e nënshkruara sot në mes të MEA-së dhe Komunës së Gjakovës janë nga fusha e mbrojtjes së mjedisit dhe

ambientit. Në marrëveshjen e parë hyn ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Gjakovë, projekt ky jashtëzakonisht i rëndësishëm

për komunën dhe qytetarët e Gjakovës. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve përfshihet edhe ndërtimi i pendës tek Ura e Fshenjtë si dhe rregullimi i shtratit të Lumit Krena në Gjakovë", ka thënë Nitaj.

Më tej, i pari i MEA-së u shpreh se Qeveria e Kosovës, respektivisht ministria që ai drejton, ka kohë që i ka mbështetur komunat e Kosovës, në mënyrë të posaçme ka mbështetur Komunën e Gjakovës në projekte të ndryshme, me theks të veçantë ato mjedisore.

Nga ana e tij, kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, falënderoi ministrin Nitaj për përkrahjen që MEA ka ofruar dhe po ofron për avancimin dhe realizimin e projekteve kapitale në Komunën

e Gjakovës. "Marrëveshja e cila ka të bëjë me vazhdimin e punimeve në Lumin Krena, segmentet e tanishme të shëtitorës janë kryer me shpenzimet tona, kurse për tre vjetet e ardhshme do ta kemi mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit. Projektin e dytë e përbëjnë tenda, lifti dhe kampingu tek Ura e Fshenjtë i cili, po ashtu, do të jetë bashkëfinansim në mes të Komunës së Gjakovës dhe MEA-së", ka thënë Gjini.

Kryetari Gjini tha se projekti i vazhdimit dhe përfundimit të kolektorëve dhe impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, i cili ka filluar në vitin 2018 me mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, pritet që të përfundojë shpejt.



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

# Zaret u hodhën, kush do të mbytet dhe përmbytet më 14 shkurt 2021

**Hyrje:** Më parë është caktuar data e zgjedhjeve, kurse më 1 shkurt është hedhur shorti për renditje të partive politike që janë bërë me numra. Është interesant fakti se hiç këtu Nismën e cila e mori numrin 121, katër parti të mëdha shqiptare morën numrat, që me një ndryshim të vogël mund dhe besoj se do të jetë edhe renditja pas zgjedhjeve të 14 shkurtit. LV-ja ua kërkon votën qytetarëve me numrin 127, LDK-ja e ka numrin 132, PDK-ja garon me numrin 134, kurse AAK-ja me numrin 135. Ndërkaq, Lista Serbe, si parti e Serbisë në Kosovë, do ta ketë numrin 119. Të gjitha partitë, për t'u treguar më të forta dhe për të fituar sa më shumë vota, janë stolisur me slogane, për mua krejtësisht të paqëlluara. Pra, të fillojmë me hedhje të fallit, me më pak kompetencë dhe besueshmëri se zonja Meri. Po shkojmë nga renditja e partive që mund të

jenë pjesë e Kuvendit të Kosovës, pas zgjedhjeve të 14 shkurtit 2021.

1. **Lista Serpska** nr. 119 nuk e di se ka ndonjë slogan garues, por më së shumti do t'i shkonte slogan: "Poshtë Kosova dhe rrofshin Aleksandar Vuçiqi dhe Sllobodan Millosheviqi". Kjo parti që është ngjizur, është formuar dhe po forcohet nga çetnikizmi i Aleksandar Vuçiqit, Dikoviqit dhe Ivica Daçiqit e që haptazi deklarohet se shteti i tyre është Serbia dhe se kryetar e kanë Aleksandar Vuçiq, si mirëmbajtës i kriminit të organizuar në veri të Kosovës e që dhunshëm eliminoi nga skena politike të gjithë serbët që ndihen si qytetarë dhe shtetas të Kosovës, në çdo vend normal do të mbyllet dhe nuk do të lejohej jo të bëhet pjesë e institucioneve të Kosovës, por as të marrë frymë në këtë mjedis, shumë të ndotur politikisht e që quhet Kosovë. Por, me ndihmën e disa

ndrikullave ndërkombëtare dhe politikanëve të kriminalizuar kosovarë, LS-ja jo që ka rrezik të përmbytet por, me gjasë, edhe do të rritet pas zgjedhjeve të 14 shkurtit me iniciativat vazale në Graçanicë dhe pjesën e okupuar të Mitrovicës. Ka shumë mundësi të fitojë 14 deputetë përmes kontrabandimit të Adrianës së hoxhajve dhe Gazit të salianve. Këtë e bënë sipas modelit të Bosnjës dhe urdhrin të neoçetnikut, Aleksandar Vuçiq. E patë se çka deklaruan Aca dhe Gorani pas vizitës në "Tokën e premtuar" të Fidel Kastros të Kosovës dhe Evita Peronit të Kosovës. Reaguan sikur këta do ta shkelnin tokën ku është varrosur Otac Pavli në Serbi e jo në një pjesë që ka qenë dhe aktualisht është pjesë e Kosovës, nëse u referohemi kufijve të Kosovës në të cilët është pranuar si shtet nga 100 shtete të botës. Largimi nën kërcënim të huliganëve serbë i Albinit dhe

Vjosës nuk është, as i pari e as i fundit. I ndjeri Bajarm Rexhepi si kryeministër i Kosovës pati bërë një përpjekje por iku, ku sytë - këmbët dhe ishte njeriu më i lumtur kur e "përfundoi vizitën për integrim të komunitetit serb". Hasha i pati flladitur koç... në Liqenin e Ujmanit, sigurisht me një leje speciale. Pacolli e pati shkelur veriun, sikur Hanibali Romën, me shumë përcjellës të armatosur ndonëse, sipas meje, edhe po të shkonte me brekë banje, askush nuk do t'i thoshte asgjë. Agim Gushafci gati e shqeu gushën duke sharë me nënë një shqiptar në Mitrovicë ndërsa, kur ia shanë dhe fyen liderët që përbetohet në emër të tyre dhe që madje Albinit e krahasoi me Hasan Prishtinën, nuk pati guxim ta bëjë as edhe një pordhë të vetme. Nuk është Agim Bahtiri Hasan Prishtina, por është Hasan Pordha i Albin Kurtit sot, dhe Behgjet Pacollit

dje. Është shembulli më besnik i profilit të një politikani të mjerë, që vetëm në Kosovë mund të bëhet politikan. Dhe, nuk është i vetmi, por është i vetmi që sipas Albinit qenka i denjë të krahasohet me Hasan Prishtinën. Çfarë fyerjeje, çfarë mallkimi!

2. **Nisma Socialdemokrate:** E ka një slogan të cilit askush nuk i beson, madje as edhe ai që e ka dhënë idenë: Me Çlirimtarët. Nisma Socialdemokrate, si themi ne në Llap: "Do të pjellë mace të zeza në përpjekje për ta kaluar pragun...", nëse edhe e kalon. Unë, tash për tash, mendoj se gjasat i kanë 50 % me 50 %, një ditë para zgjedhjeve do ta jap prognozën përfundimtare. Nuk mund të jeni vetëm ju me çlirimtarët, kurse PDK-ja, AAK-ja dhe pjesa burimore e LV-së të mos jenë me çlirimtarët. Edhe në LDK kishte çlirimtarë. Slogan i huqur që lehtësisht mund ta ketë një efekt tjetër, jo fort të

shëndetshëm elektoral.

**3. Vetëvendosje!** E ka sloganin garues "Krejt dhe drejt!" Në demokraci nuk ka Krejt dhe Drejt, sidomos jo në politikë. Në politikë patën fituar krejt, por jo edhe drejt, Lenini, Stalini, Titoja, Enveri, Musolini, Hitleri, Millosheviqi dhe Karaxhiqi, prandaj e patën fundin kur i humbën krejt dhe drejt. Slogani 'Krejt dhe drejt' për mua është slogan racist, përjashtues, sepse nuk mund të keni krejt për vete e të jeni të drejtë ndaj të tjerëve! Me 'Krejt dhe drejt', Albini synon të gjitha votat, të gjitha postet, të gjitha nderet, por jo edhe të gjitha përgjegjësitë! Në funksion të këtij slogani është edhe lista për deputetë e LV-së të cilën as Frankeshtajni nuk do të ishte në gjendje ta bënte të tillë. Aty gjeni çdo gjë përveç një racionaliteti politik bashkëpunues me partitë e tjera si dhe frymë apo përmbajtje kombëtare. Albin Kurti shkoi te varri i Ibrahim Rugovës, e lavdëroi shumë, ndonëse i mungon sinqeriteti absolut. Pse ka shkuar, nuk ka asgjë të keqe sepse tash është pjesë aktive dhe agresive e politikës duke e kooptuar Vjosa Osmanin në listën e LV-së. Pra, ka shkuar dhe do të shkojë edhe në të ardhmen dhe për këtë nuk duhet të kritikohet nga askush mirëpo, në anën tjetër, mos të na çanë trurin me frymën demaçiane në LV. Në çdo subjekt tjetër ka më shumë frymë demaçiane se në LV. Madje, sot në listën e LV-së për deputetë ka të tillë që kanë folur dhe shkruar kundër Bacës Adem më shumë se shumë gazeta të Beogradit. Ka mohues dhe urreyes të Bacës Adem. Nuk e mohoj se në atë listë ka patriotë që dikur e kanë dashur, çmuar dhe respektuar Bacën Adem! Thashë shumë qartë, dikur! Në mesin e tyre është, pa asnjë dyshim, edhe vetë Albin Kurti! Mund ta dokumentoj me 100 raste dhe fakte këtë. Është kohë fushate dhe nuk dua ta dëmtoj askënd. Vjosa Osmani është medaljoni i quajtur farsë politike. E lëshoi LDK-në për ta nënshtruar bashkë me Albinin për tokë në zgjedhjet e 14 shkurtit e që, pastaj, të poshtëruar dhe të fyer ta bëjë bishtalec të LV-së. Vjosa Osmani sot nuk ka asnjë përkrahje politike nga ish-subjekti politik që e lindi, e rriti dhe politikisht e ngriti, përveç një delikuenti seksual dhe një tjetri që ia ka futur vete në kokë se është autoritet politik, ndonëse forca dhe ndikimi i tij politik është aq sa edhe gjatësia dhe përmbajtja e mbiemrit që e ka! Si e pavarur politikisht, për fat të keq, Vjosa Osmani është e humbur, si aksesori i Albin Kurtit dhe LV-së gjithmonë do ta ketë një post! Ambalazhimin e jashtëm do ta ketë S'GUXO, kurse përmbajtjen 100 % LV. E

rëndë për një politikane që i ka pasur të gjitha rrugët e hapura, ndërsa ia ka mbyllur vetes, pa të keqen e askujt! Albin Kurtit po i duket e ngushtë këmisha e Kosovës, prandaj po i shtrinë tentakulat e pushtetit në Shqipëri, jo për të marrë pushtet, por për ta sfiduar Edi Ramën dhe përkrahur kandidatin e Vetëvendosjes nga Tropoja për zgjedhjet e prillit, kameleonin politik, Sali Berisha. Në Shqipërinë nuk e kemi shtet kundërshtar e lëre më armik dhe nuk kemi nevojë t'i mbrojmë të drejtat e shqiptarëve atje. Përkundrazi, kemi shumë nevojë për përkrahje nga Shqipëria sepse pa Shqipërinë do të shndërroheshim në kurdë të Ballkanit. Nuk ka nevojë LV-ja ta luaj rolin e Kominternës, Internacionales Komuniste midis dy luftërave botërore. Këta mercenarët e Kominternës në Shqipërisë që deklarojnë se duhet të luftohen bandat shqipfolëse në Prishtinë, le ta trusin bythën që e kanë shitur për një grusht lekësh, sot tek Albini, nesër te të gjithë ata që u japin lekë! Nëse Albini e konsideron Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, atëherë duhet ta respektojë parimin e mosndërhyrjes në punë të brendshme të një shteti fqinj. Do të ishte shumë më e logjikshme që LV-ja të hapë zyrë në Beograd, të marrë pjesë në zgjedhje atje dhe t'u mbrojë të drejtat e mohuara shqiptarëve të Luginës. Lëreni Shqipërinë të merret me problemet që i ka sepse, edhe ashtu keni deklaruar se nuk e kemi ndërmend ta ndezim luftën e tretë ballkanike për t'u bashkuar me Shqipërinë. Duket se vetëm tash Albini ka filluar të merret seriozisht me politikë duke e djegur kartën më të fortë për manipulim, bashkimi me Shqipërinë në

emër të së cilës janë vrarë edhe aktivistë të LV-së, Arben Xheladini dhe Mon Balaj ose janë çollomitur nga policia e UNMIK-ut dhe EULESH-it shumë aktivistë të LV-së dhe simpatizantë.

**4. Lidhja Demokratike e Kosovës:** Garon me sloganin 'Shteti. Shtet' në kohën kur Kosova, duke mos e kontrolluar afërsisht 30 % të territorit ku nuk e shtrinë as sovranitetin efektiv dhe ku një shtet armik si Serbia është bërë aksionar i një pjesë të Kosovës, më i mirë do të ishte slogani: Do ta bëjmë shtetin. LDK-ja, në situatën aktuale, nuk kishte tjetër mundësi, ose të veprojë si ka vepruar, ose përmes Vjosës ta kooptojë krejt partinë në LV. Isa Mustafa nuk ka pasur tjetër alternativë. LDK-ja edhe mund të dëmtohet në këto zgjedhje, por jo edhe të shembet siç po e dëshirojnë ata që janë afirmuar në këtë parti, ose ta ruajë substancën dhe investimin 32-vjeçar në politikë dhe procese nëpër të cilat ka kaluar Kosova. LDK-ja duhet të reformohet në kuptimin se duhet të krijojë shumë më tepër hapësirë për politikanë të rinj në vendimmarrje e që i ka munguar deri më tani. Aktualisht LDK-ja është si një ekip futbollit që e ka një 11-tësh të mirë, por se ka zëvendësues mesatar apo edhe të dobët. Lista e LDK-së është, edhe e baraspeshuar sikur që është normale në kuptimin se nuk mbyll rrugë për bashkëpunim, nuk fyen askënd dhe intelektualisht është e qëndrueshme. Këta politikanë që janë në listë që llogaritet të jenë pjesë e Kuvendit të Kosovës kanë bagazh të dëshmuar profesional dhe intelektual sikur edhe përvojë të gjatë politike. Askush nuk mund t'ua mohojë të drejtën që ta respektojnë, kujtojnë dhe nderojnë

themeluesin kryesor të saj dhe kryetarin e parë, Ibrahim Rugova, por duhet ta kuptojnë dhe të binden se varrin e tij nuk mund ta përdorin si kuti për vota. Është problem dhe mendoj e pamundur që proceset kryesore në Kosovë, ende të papërfunduara mund të bëhen pa LDK-në. Nëse vërtet nuk ndodh një përmbyse vërtet e madhe.

**5. Partia Demokratike e Kosovës:** 'Rimëkëmbje' është slogan që, për mendimin tim, do të vlente ekskluzivisht për rimëkëmbje të vet PDK-së nga goditjet që ia ka dhënë Gjykata Raciste Speciale sikur edhe një pjesë e vet udhëheqësve të partisë të shndërruar në bataçinjtë dhe cuba politikë të cilët partinë e kanë përdorur për përfitime personale, duke e dëmtuar shumë partinë. PDK-së i kanë rënë shumë detyrime pas përfundimit të luftës, deri në shpallje të pavarësisë. PDK-ja ka qenë subjekti më i sulmuar, nga jashtë si dhe nga brenda dhe, çuditërisht, ndonëse është goditur, me të drejtë dhe pa të drejtë, ka mbijetuar dhe ka ruajtur një elektorat, sidomos në zgjedhjet e fundit. Dobësitë e PDK-së për këto zgjedhje janë mungesa e votave në Anamoravë dhe Dukagjin (vetëm Ramiz Kelmendi këtu mund të sigurojë vota). Tjetër mangësi është se nuk ka një adresë të qartë dhe të pakundërshtueshme të vendimmarrjes. Për këtë edhe situatat që i shkonin shumë në favor, me papërgjegjësinë e disa anëtarëve e kanë kthyer kundër sikur që ishte rasti me "votuesit nga Kraleva" dhe vizita e Boni dhe Klajdit në Skenderaj. Reagimet pas kësaj vizite ishin në kundërshtim të plotë me një politikë racionale duke e kthyer situatën në favor të dyshes Kurti-

Osmani. Përparësi e PDK-së është angazhimi, ndonëse me vonë në terren dhe fakti se në PDK janë 35-40 veta që çkyhen për vota dhe, në këtë mënyrë, sigurojnë vota edhe për partinë. PDK-ja duhet të qëndrojë në opozitë, por duhet të luajë rol konstruktiv.

**6. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës:** Slogani 'Forca e Kosovës' lidhet me forcën e Ramushit dhe Dautit. Pa ta do të shndërrohej në shampite e Kosovës. Udhëheq në disa komuna të Kosovës dhe ka elektorat që nuk lëviz drejt subjekteve tjera politike. Ministrat e AAK-së në qeverinë Hoti kanë befasuar në aspektin pozitiv. AAK-ja ka investuar në të rinj që shihet edhe në listën për deputetë. Afërsisht do ta ruajë trupin votues.

**Përmblyje:** Askush nuk po e vë në dyshim fitoren e LV-së. Unë aktualisht i jap 38 % të votave. Për vend të dytë do të bëjnë garë PDK-ja dhe LDK-ja. Votat e tyre do të sillen prej 20-23 % për parti. AAK-ja realisht do të duhej të sigurojë 10 % të votave, kurse Nisma është në teh të pragut.

LV-ja po luan në kartën e epërsisë psikologjike përmes një presioni dhe agresiviteti që nuk është parë, që nga përfundimi i luftës. Albin Kurti po sillet sikur Dalaj Lama. Tmerrësisht po i injoron dhe fyer subjektet e tjera politike. Ka ofruar një listë më makiaveliste se ta kishte bërë vetë Nikola Makiaveli. Vetëm për të fituar sa më shumë vota dhe duke shpërfillur të gjitha parimet e mëparshme. Në mënyrë flagrante e dhunoi idenë e bashkimit kombëtar. Nëse i fiton votat që po i japin sondazhet dhe nëse sillet me shpërfillje ndaj opozitës, përveç se do të dëmtohet demokracia, do të vendoset një autokraci e tipit të Aleksandar Vuçiqit. Besoj se Albini do të ndërrojë qasje pas zgjedhjeve. Kam përshtypje se Albini më shumë po bëhet gati për zgjedhje të reja se për konsolidim të pushtetit.

Opozita e ardhshme me asgjë nuk duhet ta pengojë Albin Kurtin për ardhjen në pushtet nëse i siguron votat sepse vetëm sa do ta forcojë më shumë. Me qasjen që e ka sot Albin Kurti, me Vjosa Osmanin, si bartëse e listës së LV-së, pas një viti do ta ketë një opozitë e cila nuk do ta lë të qetë as kur do të flejë. Albin Kurti duhet të përcaktohet, o me Listën Serbe, o me një subjekt politik shqiptar, me vota të qëndrueshme. E shohim si do të shkojnë punët. Personalisht nuk jam i sigurt se lista e Albin Kurtit do ta stabilizojë shtetin e Kosovës. Mendoj pikërisht të kundërtën. Uroj të gaboj në këto parashikime sepse Kosova është interes mbi interes të një individi, cilidoqoftë ai.



Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (18)

# Nacionalistët serbë sulmojnë punëtoritë e shqiptarëve në Serbi



Lulzim SAHITI

Ngjarja e Paraqinit kishte ardhur si rrjedhojë e revoltimit të Aziz Kelmendit me regjimin e atëhershëm jugosllav që ushtronte dhunë e terror të përditshëm ndaj popullatës shqiptare kudo që jetonte në ish-Jugosllavi. Ky veprim i Kelmendit përkon shumë me ngjarjen e 7 nëntorit të vitit 1938, kur një djalosh i ri hebre polak Herschel Grynszpan (16-vjeçar) qëlloi për vdekje diplomatin gjerman Ernst vom Rath, në Ambasadën e Gjermanisë në Paris. Asokohe akti kishte ardhur si pasojë e revoltimit të riut për shkak të debimit të familjes së tij nga Hanoveri në Poloni dhe si pasojë e torturave që kishte filluar të shfaqte regjimi nazist ndaj popullatës hebreike. Mandej, kjo vrasje u përdor si pretekst nga autoritetet naziste për t'i nisur torturat dhe shfarosjen e komunitetit hebre duke filluar nga nata e 9 nëntorit të vitit 1938, kur nazistët gjermanë organizuan demolimin e dyqaneve të hebrenjve në Gjermani. Përndryshe ky veprim i tyre njihet si Kristalnacht (Nata e Kristaltë).

Një veprim të tillë e bëri edhe pushteti serb përmes fushatës së egër mediale. Lajmi për vrasjen e katër ushtarëve dhe plagosjes së pesë të tjerëve kishte zënë vend në të gjitha ballinat e gazetave ditore serbe. Kjo vrasje u përdor si pretekst nga autoritetet serbe për ta nxitur fushatën e madhe antishqiptare, e cila po merrte tiparet e fashizmit dhe çonte drejt fundit politik të Jugosllavisë federale dhe shumetnike. Disponimi antishqiptar i nxitur nga këto media rezultoi me veprime vandale të grupeve nacionaliste serbe. Ditëve në vijim, shumë nga ëmbëltoret, furrat e bukës, kioskat dhe punëtoritë në Serbi, Vojvodinë dhe Mal të zi, pronarë të të cilave ishin shqiptarët, u demoluan. Ky vandalizëm ta kujton "Natën e Kristaltë" të nazistëve gjermanë, por tash të organizuar nga nationalistët serbë.

Në kumtesën e lëshuar në Beograd më 11 shtator 1987 nga Sekretariati Republikan për Punë të Brendshme të Serbisë, thuhet se vetëm në periudhën prej 3 deri më 11 shtator 1987 në territorin e Republikës së Serbisë u bënë 27 sulme në objekte e persona të kombësisë shqiptare. Në vazhdim po përmendim vetëm disa raste të tilla që janë shkaktuar në Serbi,

Vojvodinë dhe Mal të Zi:

Më 6 shtator 1987 në Paraqin u thyen vitrinat e dy ëmbëltoveve "Sport" dhe "Pelivan". Pronarë të dyqaneve ishin shqiptarë, Demir Menasa dhe Bermedin Ademi. Më 7 shtator 1987 në Valevë u thye vitrina e furrës private e Osman Shaipit. Më 8 shtator 1987 në qendër të Leskovcit u thye me gurë vitrina e ëmbëltores "Egipet", pronar i së cilës ishte Abdulla Ilijazi.

Më 9 shtator 1987, në Suboticë u thyen xhamat në dy objekte, pronar të të cilave janë shqiptarët. Në shënjestër ishin kafeneja e pronarit Abdi Nishat Abdiut dhe ëmbëltoja e Remzi Abdyl Rufatit. Kjo veprim është bërë si formë e manifestimit të disponimit antishqiptar.


Më 11 shtator 1987 u thye në Valevë vitrina e ëmbëltores "Tip-top", pronarë e Mesut Memetit. Më 13 shtator 1987, në Suboticë nga huligan u thyen vitrina e dyqanit privat të bukës të Isuf Fetahut. Ndërkaq, në Nikshiq u thyen vitrinat e tri ëmbëltoveve, njëri nga pronarët e tyre ishte shqiptar ndërsa dy tjerët myslimanë.

Në mëngjesin e 14 shtatorit të vitit 1987, në Smederevë nga Zhivoin Joksiq u thyen vitrina e qebaptores së Mehmet Dautit. Në Smederevë, asokohe kishte mjaft dyqane, pronarë të të cilave ishin shqiptarë.

Në natën ndërmjet 16 e 17 shtatorit të vitit 1987, në qendër të Aleksincit, u thyen me gurë vitrinat e ëmbëltoveve të Xhemail Musës nga rrethi i Prizrenit dhe Anastasie Topçevskit nga Maqedonia.

Dënime për kundërvajtje për solidarizim me Aziz Kelmendin

Meqenëse Serbia historikisht



Aziz Kelmendi

gjithmonë ka ushtruar dhunë e terror ndaj popullit shqiptar sidomos pas ngjarjeve të vitit 1981 kishte ashpërsuar fushatën propagandistike dhe veprimet e drejtpërdrejta kundër institucioneve të Kosovës. Kjo bëri që shqiptarët në mënyra të ndryshme të vetorganizohen kudo që ishin në mbrojtje të qenies së vet kombëtare. Është interesante se rasti Paraqinit nga institucionet dhe mediet e atëhershme të Kosovës dënohej publikisht mirëpo populli në heshtje e kishte mbështetur veprën heroike të dëshmorit Aziz Kelmendi, meqë nga zullumi i madh që u bëhej ushtarëve shqiptarë që shërbenin në armatën jugosllave u kishte ardhur shpirti deri në majë të hundës. Madje edhe në atë kohë shumë të vështirë që kalonte populli ynë kishte individ nga të gjitha trojet shqiptare në ish-Jugosllavi që u solidarizuan me Aziz Kelmendin. Edhe pse deklaratat e tyre ishin delikt verbal

janë dënuar me nga 60 ditë burgim. Ndonëse kishte shumë, po përmendim vetëm disa raste të tilla:

Më 9 shtator 1987, Gjyqi Komunal në Nikshiq, Bilall Avdyllaj (29-vjeçar) nga Çitaku, afër Skënderajt, punëtor i organizatës ndërtimore "Prvoborac" në Nikshiq u dënua me 60 ditë burg për shkak të solidarizimit me Aziz Kelmendin. Menjëherë është dërguar në vuajtjen e dënimit në Shtëpinë Korrektuese - Përmirësuese "Veke Brdo" në Spuzh, afër Podgoricës së Malit të Zi.

Më 11 shtator 1987, Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Hercegnovi ka dënua me 60 ditë burg, Sherif Koliqin (23-vjeçar) nga Peja. Menjëherë ishte dërguar në vuajtje të dënimit. Koliqi ndodhej përkohësisht në Hercegnovi dhe për shkak se më 7 shtator 1987 në restorantin "Privnica" gjatë lajmeve në radio ishte folur për Aziz Kelmendin dhe për te kishte thënë: "Unë atij do t'ia kisha dhënë një dekoratë rreth qafe".

Më 11 shtator 1987, Nezir Dalipi (59-vjeçar) nga Ohri, punëtor i shkrites së OP "Zastava - Heroi Toza Dragoviq" në Ohër u pezullua nga puna ngase u solidarizua me Aziz Kelmendin. Neziri, më 4 shtator 1987, duke punuar në ndërresën e dytë, kishte komentuar ngjarjet lidhur me rastin e Paraqinit dhe me atë rast shoqës në punë, Vesela Rajkoviqit, i kishte thënë: "Kështu duhet vepruar me gjithë ju". Krahas pezullimit nga puna, SPB-ja e Ohrit kishte dorëzuar fletëparaqitje për kundërvajtje.


Më 12 shtator 1987 në Gjyqin Komunal të Plavës u dënua me 60 ditë burg Musli Hakanjini, inxhinier i repartit në KPI "Bor"

për shkak të solidarizimit me Aziz Kelmendin. Inxhinieri Musliu në praninë e drejtorit të vet Millomir Millosheviq për rastin e Paraqinit kishte thënë: "Edhe unë do ta bëja këtë!"

Në mbledhjen e Shoqatës numër 2 të Bashkësisë Lokale të Korreticës së Epërme (Drenas), të mbajtur në mbrëmjen e 18 shtatorit të vitit 1987, pensionisti Vesel Balaj nga Korretica e Epërme, kishte shprehur publikisht qëndrimin e vet për rastin në Kazermën e Paraqinit, i cili asokohe ishte solidarizuar me ushtarin Aziz Kelmendi duke thënë: "Ndoshta Azizi nuk ka pasur kah t'ia mbajë". Për këtë, anëtarët e Shoqatës në fjalë, ishin kacafytur me te dhe me dhunë e nxjerrin nga tubimi. Të nesërmen pasdite, më 19 shtator 1987, me procedurë të shpejtë, Gjykata për Kundërvajtje e Gllgovcit, kishte dënua pensionistin Vesel Balaj me 60 ditë burg për "eksponim destruktiv" dhe menjëherë e kishin dërguar në vuajtje të dënimit.

Më 30 shtator 1987 në Gjykatën Komunale të Tetovës iu shqiptua dënimi me 60 ditë burg Qatig Ismajlit (39) nga Tetova vetëm pse ka përkrahur haptazi Aziz Kelmendin në praninë e punëtorëve të kantierit të gjashtë të "Betoni"-t në Tetovë, duke thënë se edhe ai do të vepronte ashtu.

Më 19 janar 1988 Gjykata Komunale për Kundërvajtje e Tetovës ka dënua me 60 ditë burgim Gani Ibrahimin (19-vjeçar) për shkak se më 13 janar 1988 në vendin e tij të punës "Makedonia Tabak" në Tetovë në praninë e punëtorëve të tjerë ka arsyetuar veprimin e Aziz Kelmendit në Kazermën e Paraqinit. (Vijon)





**MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO**

**GENERAL PROCUREMENT NOTICE (GPN)**

Government of the Republic of Kosovo

Millennium Foundation of Kosovo (MFK)

The Government of the Kosovo has received grant funding of USD\$49 million (Forty-Nine Million United States Dollars) from the Millennium Challenge Corporation (MCC) of the United States Government to enable the Government of the Republic of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Threshold agreement, and it intends to apply parts of the funds to payments for contracts for goods, works and services.

MCC's funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the compact up-front, with no incremental or partial funding. When a contract is signed with an MFK, money is already available to the MFK and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

The procurement program for this period will include the following:

Procurements for period February 2021 – December 2021
<i>Procurement of Goods</i> In the Reliable Energy Landscape Project including:
DHM - Metering system supply & installing
<i>Procurement of Works</i> In the Reliable Energy Landscape Project including:
Household Efficiency Retrofits (HER) Intervention Package - EE materials and products
AER -Apartment Building Efficiency Retrofits Sub-activity Works
<i>Procurement of Services</i> In the Reliable Energy Landscape Project, Transparent Governance Project and Administration sector, including:
Software, Hardware, and TA in Communications & Outreach for the Public Access to Judicial Information Activity (Case Management Information System "CMIS")
Consultancy (Stakeholders workshops for Judicial Dig Data Challenge)
Procurement of Consultant Services IPP and Energy Efficiency Project Accelerator and Pipeline Development Consultant: Demand-Side Training, Firm-Level Engagement, and Marketing Strategy
Communication and Outreach for Judicial Data Challenge
Event Management for CMIS workshops and promotional activities
Consultants - Jury for Open Data Challenge
Dig Data Air Quality Awards Ceremony & Promotion and Events for the Energy Dig Data
Judicial Dig Data Challenge Consultant
Consultants - Jury for Energy Open Data Challenge
Programmatic Communications
Outreach activities and the launch event for the Internship Program
Data Quality Review for Reliable Energy Landscape Project and Transparent Governance Project

Contracts for goods, works and services financed under the program will be implemented according to the principles, rules and procedures set out in the MCC Program Procurement Guidelines, which can be found at the MFK website.

The procurement is open to all bidders from eligible source countries as defined in the MCC Program Procurement Guidelines.

Specific procurement notices for contracts to be tendered under the competitive bidding procedures and for consultant contracts will be announced, as they become available, on the MFK website: <https://millenniumkosovo.org/>, United Nations Development Business (UNDB): <http://www.devbusiness.com/>, Development Gateway Market (dgMarket): <http://www.dgmarket.com/>, in local newspapers, and other media outlets as appropriate.

Interested eligible contractors and consultants who wish to be included on the mailing list to receive a notice of advertisements should subscribe on the MFK website under the link: <https://millenniumkosovo.org/subscribe/>, type your email and select under the list Procurement, or those requiring additional information, should contact:

Procurement manager:	Arton Çitaku – MFK Procurement Manager
c/o:	Millennium Foundation of Kosovo
Address:	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Telephone:	+ 383 38 752 110
Email:	procurement@millenniumkosovo.org



**Gjeje PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejepuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejepuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Realizimi i ndodhë që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë theks të mendimit, shprehim profesional dhe njëzetor të një krijimtarië fiktionale dhe më të gjerë në librin e Agron Shalës. Një libër i Kështjës që i lëviz të hapura vlerat e tij. Shala nuk pretendon të mëtojë asgjë por, duke shprehur në dimensionin artistik, politik, fetar e njëzetor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zyber Kelimendi**

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieslowski, i ndihëtur me një egjezë të lirë autorale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Në libër shkruar me një gjuhë të mprehshme, që me çdo fjalë të shpreh të lexuesit më të shtj. Konsideroj se ky libër përmban një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shufi**

Një libër që zbaton relacionet e njërut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një veprë fiktionale, por që përçohet të në nëpërmjet urdhërave biblike. Autori në mënyrë të mprehshme dhe me delikatesë e ndërlic të temën e besimit në Zot, shkëlqenditë e relacioneve të shqiptarët, duke bërë ndërtim me fenë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krijimtarië intelektuale, e që do të duhet të lexohet nga secili.

**Fadil Sahiti**

... përmasa mikrobota të Kieslowski, "Dekalogu" i Agron Shalës në dëshmon se mund të regjilet metamorfoza progresive e mendjes tonë.

**Orhan Kerkezi**

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieslowski dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet theksi se "shqiptarët janë madhshpirt".

**Daut Dauti**

ÇMIMI: 5.99 €

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIESLOWSKI

AGRON SHALA

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIESLOWSKI

**DEKALOGU**  
[nga Moisiu deri te Kieslowski]

Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në ditëgen e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetarinë. Shkruar e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër theksuesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbuar anëtar i Këshillit Qendror të Zëritshëve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studimes i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe resthënie i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpuçe në Berlin* është novela e tij e parë.

**Daut Dauti**

**NJË PALË KËPUÇË NË BERLIN**  
novelë

4 €

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Realizova ëndrrën e të gjithë familjes



**“Arritja e normës olimpike ka qenë ëndrra e gjithë familjes, andaj atyre dhe gjithë përkrahësve të mi ua dedikoj këtë sukses”, ka deklaruar Arbi Pupovci**

**PRISHTINË, 3 SHKURT** - Arbi Pupovci është sportisti i parë i Kosovës që siguroi një normë olimpike për Lojërat Olimpikë Dimërore “Pekin 2022”. 20-vjeçari nga Peja mbledhi pikët e mjaftueshme të Federatës Ndërkombëtare të Skitarisë (FIS) për ta fituar normën olimpike në disiplinën e sllallomit të skijimit alpin. Për ta fituar normën në këtë disiplinë duheshin pesë rezultate me pikë më pak se 160 në një garë. Pupovci rezultatin e pestë e arriti javën e kaluar në Pamporovo të Bullgarisë, ku edhe u ngjiti në podium si vendi i tretë. Paraprakisht mori pjesë në Borovets të Bullgarisë, në Kollashin të Malit të Zi, si dhe në Erzurum të Turqisë.

Krahas Pamporovos, medaljen e bronzit e kishte fituar edhe në Erzurum në dhjetor të vitit të kaluar. “Është ndjenjë shumë e mirë. Jam shumë i lumtur që e arrita këtë synim. Nuk ishte aspak e lehtë, sepse është dashur të marrësh pjesë në gara dhe t’i përsëritësh rezultatet. Po ashtu, në Borovets, kushtet ishin të vështira, ndërsa në Pamporovo më mirë”, ka thënë Pupovci për Komitetin Olimpik të Kosovës.

Arbi rrjedh nga një familje, që gati tërë jetën ia ka kushtuar sportit të dimrit. Është fëmija i tretë, kurse

babai i tij është Agim Pupovci, përzgjedhës i Kosovës në skitari. Vëllezërit e Arbit janë Taulanti, Dardani dhe Eordejti, ndërsa motra, Arba, e shoqëroi në disa gara ndërkombëtare të këtij viti. Dy vëllezërit më të mëdhenj, Taulanti dhe Dardani, e ndihmojnë Arbin në cilësinë e trajnerëve. “Arritja e normës olimpike ka qenë ëndrra e gjithë familjes, andaj atyre dhe gjithë përkrahësve të mi ua dedikoj këtë sukses”, ka deklaruar Pupovci, garuesi i klubit Alpi të Pejës. Misioni i radhës për Arbin është kampionatin botëror i cili prej 8-21 shkurtit 2021 mbahet në Cortina d’Ampezzo të Italisë, vend ky që në vitin 2026 bashkë me Milanon do t’i mirëpresin Lojërat Olimpikë Dimërore. “Në botëror synoj të kualifikohem për në garën kryesore në të dyja disiplinat, sllallom dhe sllallom të madh. Nëse e arrij këtë, atëherë shpresoj të hyjë në top 50-she, që do të ishte sukses”, ka shtuar ai.

Në botëror, krahas Arbit, do të marrin pjesë edhe Albin Tahiri e Fiona Blaka Rusta. Tahiri kishte përfaqësuar Kosovën në Lojërat Olimpikë Dimërore “Pyeong Chang 2018”, në të pesë disiplinat e skijimit alpin. Edhe ai është duke garuar për ta fituar normën. Ekipi olimpik i Kosovës nuk

mund të marrë pjesë në Olimpiadë me dy garues të së njëjtës disiplinë. Një gjë e tillë mund të ndodhë vetëm nëse ndonjëri prej skitarëve tanë ndodhet në top 30-she në disiplinë. “Meqë Arbi ka siguruar normën, Albini shkon në disiplinë tjetër”, ka thënë përzgjedhësi Agim Pupovci. Tahiri pritet ta fitojë normën olimpike në të pesë disiplinat, por në Olimpiadë me gjasë do të garojë në disiplinat më të shpejta si: super sllallom të madh, lëshim dhe kombinim alpin.

Pupovci, krahas sllallomit, synim e ka ta fitojë normën edhe në sllallom të madh ku, po ashtu, duhen pesë rezultate me pikë nën 160. Normën olimpike po e kërkon edhe Fiona Blaka Rusta e Kiana Kryeziu në disiplinat sllallom dhe sllallom i madh, por që me rezultate janë ende larg. Arbi, Albini e Fiona janë bursistë të KOK-ut për LOD Pekin 2022. Ata marrin bursë prej nëntorit të vitit 2019. “Bursa më ka ndihmuar shumë, sidomos në përgatitje, ushtrime fizike, udhëtime etj”, ka shtuar Pupovci, i cili me ski ka filluar të stërvitet prej moshës katërvjeçare. Lojërat Olimpikë Dimërore mbahen prej 4 deri më 20 shkurt 2022 në Pekin të Kinës.

## SHKURT

### Drita përfundoi përgatitjet në Turqi

Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll dhe liderja e klasifikimit në Superligë, Drita, ka përfunduar të mërkurën fazën përgatitore në Turqi. Në njoftimin e klubit nga Gjilani bëhet me dije se gjatë kësaj faze gjithçka ka shkuar sipas planifikimeve dhe asnjë futbollist nuk është lënduar. “Të mërkurën ka qenë dita e fundit e fazës përgatitore në Antalia të Turqisë. Ekipi ka qëndruar për 15 ditë dhe ka zhvilluar gjithsej pesë ndeshje kontrolluese. Gjithçka ka shkuar mirë dhe ashtu siç është planifikuar. Na gëzon fakti që gjatë kësaj faze nuk kemi pasur ndonjë lëndim dhe kjo ka qenë shumë e rëndësishme. Pas kthimit në Kosovë, më 9 shkurt do ta kemi ndeshjen e parë për këtë vit përballë ekipit të Prishtinës në kuadër të Kupës së Kosovës”, thuhet në njoftimin e skuadrës gjilanasë.

### Xhaka: Nuk meritua humbjen

Skuadra e Arsenalit pësoi humbje nga Wolves (2-1), por interesant ishte fakti se “Topçinjtë” luajtën pa dy lojtarë, pasi David Luiz dhe portieri Leno u përjashtuan nga loja. “Jam i dëshpëruar. Nuk e meritua këtë”, ka shkruar Xhaka.

### Haris Berisha vazhdon kontratën me Kreuzlingenin

Portieri i Kombëtares së Kosovës, Haris Berisha, do të vazhdojë të paraqitet për skuadrën zvicerane Kreuzlingen. Shtatlarti Berisha të mërkurën ka vazhduar kontratën me Kreuzlingenin deri në qershor të vitit 2022. Ai kishte kontratë deri në qershor të këtij viti. Berisha është shquar me paraqitje të mira në Ligën B të Zvicrës dhe te Kreuzlingenin kanë vendosur që t’ia besojnë portën edhe për kampionatin e ardhshëm. Kreuzlingenin po synon kalimin në elitën e Zvicrës.

### RC Cola Drita në finale të Kupës

RC Cola Drita ka shënuar fitore ndaj Istogut 64:69 (22:24, 8:16, 19:13, 15:16), në ndeshjen e parë gjysmëfinale të Kupës së Ligës së Parë. Ndeshja nisi e baraspeshuar me të dyja skuadrat që nuk arrinin të shpëputeshin në rezultat, derisa çereku i parë përfundon 22:24. Gjilanasit ishin më të mirë në periudhën e dytë, që e fitojnë 8:16, derisa pjesa e parë përfundon 30:40. Istogasi e fillojnë më mirë pjesën e dytë, duke barazuar shifrat në 45:45, derisa rezultati pas 30 minutash në semafor ishte 49:53. 10 minutat e fundit ishin interesante, por gjilanasit arritën ta ruajnë epërsinë dhe triumfuan në fund 64:69. Drita në finale të Kupës së Ligës së Parë do të përballlet me fituesin e ndeshjes Marigona Hill Prishtina - AS Prishtina, që zhvillohet të enjten nga ora 13:00.

### Indiana mposhti Memphisin

Një tjetër superxhiro ka përfunduar në NBA, derisa tifozët kanë pasur shansin që të shikojnë përballje të zjarrta. Të gjitha duelet në ligën më të ndjekur në basketboll përfunduan me mbi 100 pikë dhe kishte epërsi të ngushta. Indiana Pacers ka fituar me rezultat 134-116 ndaj Memphis Grizzlies. Fitore me rezultat komod mori edhe Toronto Raptors që fitoi me shifrat 123-108 ndaj Orlando Magicut. Në këtë javë triumfoi edhe Brooklyn Netsi kundër Los Angeles Clippersit me rezultat 124-120. Në ndeshjet e tjera u regjistruan këto rezultate: Portland Blazers-Washington Wizards (132-121), Golden State Warriors-Boston Celtics (111-107), Utah Jazz-Detroit Pistons (117-105).

## Publikimi i kontratës, Messi ngre padi ndaj pesë personave

BARCELONË, 3 SHKURT - Para pak ditësh gazeta spanjolle "El Mundo Deportivo" publikoi për herë të parë kontratën katërvjeçare mes argjentinasi Lionel Messi dhe Barcelonës për një vlerë të paimagjinueshme. Por në lidhje me këtë ngjarje e cila tronditi botën e futbollit,

Messi ka vendosur të ndërmarrë masa ligjore për këtë ngjarje. Ylli argjentinasi ka nisur procedurat dhe do të paraqesë kallëzim penal kundër pesë personave të cilët ai i konsideron të dyshuar për zbulimin e të gjithë dokumentit sekret, që një fakt përbën një krim. Sipas "Esports

Rac1", bëhet fjalë për Josep Maria Bartomeu (ish-presidenti i Barcelonës), Carles Tusquets (presidenti aktual i Komitetit të Menaxhimit), Jordi Mestre (ish-nënkryetari sportiv), Oscar Grau (CEO i klubit) dhe Roma Puntí (kreu i shërbimeve juridike të Barçës). Këta janë pesë personat

që kanë pasur qasje në kontratën e Messit, nga e cila ai përfitonte 555 milionë euro në katër vjet dhe njerëzit, që mund t'ia kenë dhënë atë gazetës "Mundo Deportivo", kundër së cilës Messi do të ngrejë gjithashtu një padi. Ndërkohë që vetë klubi ka mohuar se ka



gisht në këtë ngjarje dhe do të ndërmarrë masa ligjore për personat përgjegjës.

## FFK-ja: Gjithçka gati për fillimin e stinorit pranveror

PRISHTINË, 3 SHKURT - Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) mbajti mbledhjen e vet të radhës nën drejtimin e kryetarit Agim Ademi, ku diskutoi për shumë çështje me rëndësi në futbollin e Kosovës. KE analizoi përgatitjet për fillimin e stinorit pranveror dhe konstatoi se organet relevante të FFK-së kanë kryer dhe kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për fillimin sa më të mirë të garave. Gjyqtarët i kanë mbajtur testet e nevojshme dhe kanë treguar përgatitje shumë të mira, duke dëshmuar gatishmëri për fillimin e garave. "Klubet i kanë kryer përgatitjet e tyre, sikur edhe kanë bërë transferimet sipas nevojave të tyre. KE vlerëson se çdo gjë është e gatshme për fillimin e garave të stinorit pranveror dhe gjithnjë në përputhje me rrethanat dhe masat e Udhëzimit të IKShP-së për



Covid-19", thuhet në njoftimin e FFK-së.

KE do të vazhdojë përpjekjet dhe përgatitjet që sa më parë të instalojë edhe sistemin VAR, që do të ishte një ndihmesë e madhe në mbarëvajtjen e garave. KE, gjithashtu, do t'i mbështesë klubet në pikëpamje financiare brenda mundësive të lejuara. KE shqyrtoi dhe miratoi edhe Memorandumin e Bashkëpunimit me Federatën

e Futbollit të Turqisë si shumë të dobishëm në të gjitha fushat, në veçanti në përkrahje të infrastrukturës, organizimit e kampeve për të gjitha ekipet kombëtare si dhe për instalimin e sistemit VAR. KE diskutoi edhe për zhvillimin e të gjitha ekipeve kombëtare në këtë kohë kur ka reflektuar edhe pandemia Covid-19. KE shqyrtoi edhe ankesat dhe parashtrësat drejtuar këtij organi.

## Shqipëria më 5 qershor përballet me Uellsin

Tiranë, 3 shkurt - Federata Shqiptare e Futbollit ka njoftuar se do të luajë një ndeshje miqësore me Uellsin më 5 qershor. "Të dyja federatat kanë rënë dakord për zhvillimin e kësaj ndeshjeje. Takimi do të luhet në 'Cardiff City Stadium' dhe do të nisë në orën 18:00. Kjo do të jetë ndeshja e katërt midis Shqipërisë dhe Uellsit në histori, teksa në të kaluarën janë përballur tri herë me njëra-tjetrën", thuhet në njoftimin e FShF-së. Shqipëria ka luajtur dy herë me Uellsin për eliminatorët e Kampionatit Evropianit 1996. Ndeshja e parë u luajt në Kardif më 7 shtator 1994 dhe përfundoi me fitoren 2-0 të vendasve. Golat u shënuan nga Chris Coleman (10') dhe Ryan Giggs (67'). Në sfidën e dytë



mes dy vendeve të luajtura më 15 nëntor 1995 në stadiumin "Qemal Stafa" të Tiranës rezultati u fiksua në barazim 1-1. Sokol Kushta kaloi në

avantazh kuqezinjët me një gol të realizuar në minutën e 5-të, ndërsa uellsianët barazuan shifrat në minutën e 43-të me anë të Mark Pembridges.

### SHKURT

#### Presidenti i Tiranës rezulton pozitiv me Covid

Presidenti i Tiranës, Refik Halili, është infektuar me Covid-19. Kreu i klubit bardheblu ka rezultuar pozitiv me koronavirus në analizat e fundit. Megjithatë, kampionët në fuqi të vendit ndihen të qetë pasi presidenti i 25 herë kampionëve të Shqipërisë ndodhet në gjendje të stabilizuar shëndetësore.

#### Joao Felix rezulton pozitiv me Covid

A Atletico Madridi ka konfirmuar se sulmuesi Joao Felix ka rezultuar pozitiv në analizat e Covid-19. Portugezi është izoluar duke ndjekur autoritetet lokale dhe protokollin e La Ligës. "Lojtari ynë Joao Felix ka bërë testin PCR dhe ka dalë pozitiv me Covid-19", shkruhej në komunikatën e "Los Ríjoblancos". Tani Felix do të qëndrojë i izoluar derisa të dalë dy herë negativ në analizat e Covid-19.

#### Hamiltoni: Synoj titullin e tetë

Edhe pse e ardhmja e Lewis Hamiltonit është ende në dilemë, piloti britanik shprehet në një intervistë për "Sport Week" se ëndrra e tij është të shpallet kampion bote për të tetën herë në Formula 1. "Titulli i tetë kampion bote do të ishte diçka e jashtëzakonshme për mua. Kam frikë edhe ta përmend si numër, por ky është objektivi ku jam përqendruar me të gjitha forcat e mia", ka thënë Hamiltoni. Britaniku është piloti me më shumë fitore dhe "pole" në historinë e Formulës 1, por ende nuk ka rinovuar kontratën me Mercedesin. Palët pritet të gjejnë brenda 2 marsit një marrëveshje, datë kur do të bëhet prezantimi i makinës së re.

#### Aguero dëshiron të luajë me Messin te Barça

Kriza e thellë financiare e Barcelonës e detyron klubin të hedhë sytë nga lojtarët me parametra zero, për të shmangur harxhimet e shumta për blerjen e tyre. Së fundmi në skenë ka dalë emri i Sergio Aguero. Kontrata e sulmuesit me Manchester City përfundon në verë dhe rinovimi nuk pritet të vijë, pasi siç njoftojnë nga Spanja, sulmuesi dëshiron diçka tjetër. Ai ka në plan të kalojë te Barcelona, ku gjen Messin dhe mund të realizojë ëndrrën e tij për të luajtur në një klub me shokun e dhomës në kombëtare. Barcelona nga ana tjetër i dëshiron shërbimet e argjentinasi dhe mësohet se kandidatët për president e kanë kontaktuar për një transferim të mundshëm. Ardhja e Kun do të ishte një shtysë më shumë për të bindur Messin të qëndrojë.

#### Unitedi harron Sanchon, synon Haalandin

Pasi dështoi të transferojë Jadon Sanchon në dy afatet e fundit kalimtare, Manchester Unitedi ka hequr dorë nga anglezi, shkruan "The Express" të mërkurën. Sipas këtij mediumi, Sancho nuk është më prioritet i klubit anglez. Raportohet se Manchester Unitedi dëshiron që të blejë Erlind Haalandin e Dortmundit, që është bashkëlojtar i Sanchos. Këtë plan Unitedi po tenton ta finalizojë në afatin kalimtar të verës. Për Haalandin, që po shkëlqen te Dortmundi, janë të interesuara edhe disa klube të mëdha evropiane.

## Pirlo: Kjo është arsyeja pse e zëvendësova Ronaldon

Trajneri Andrea Pirlo e zëvendësoi Cristiano Ronaldo me Alvaro Morata katërmëdhjetë minuta pa

përfunduar ndeshja kundër Interit, të cilën Juventusit i fitoi me rezultat 1-2. Trajneri italian ka thënë se këtë veprim e bëri

për faktin se portugezi i duhet në ndeshjen e së shtunës ndaj Romës në Serinë A. "Është normale, sepse zëvendësohesh

në një ndeshje si kjo, dëshiron të vazhdojë t'i ndihmohet shokët tuaj të skuadrës, gjithashtu duhet të mendojmë për

kampionatin, pasi të shtunën kemi një sfidë të rëndësishme. Ishte e drejtë ta nxirrnim në atë moment", ka thënë Pirlo.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE  
REGIONAL WASTE COMPANY  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel. +381(0)390/321 588  
+381(0)390/324 034  
www.cabrati.com  
e-mail. info@cabrati.com  
Gjakovë - Gjakova

**K.R.M. "ÇABRATI"**

Në bazë të dispozitave të nenit 21, neni 25 paragrafi 25.2 pika h) të Ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/15 qershor 2008), respektivisht neni 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/30 maj 2012), Komisioni i Auditimit i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Çabrati" Sh.A, në Gjakovë, në mbledhjen e mbajtur më datë: **02.02.2021**, mori Vendim me Nr. 167, me të cilin shpall:

## KONKURS

**Pozita:** Auditor i Brendshëm.  
**I përgjigjet:** Komisionit të Auditimit.  
**Vendi:** Gjakovë.

### Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Udhëheqjen, menaxhimin dhe organizimin e brendshëm të Zyrës së Auditimit;
- Përpilimi i procedurave të auditimit, gjegjësisht planit të auditimit të brendshëm për të gjitha transaksionet e NP, komfor objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të NP, të bazuara në Ligjin e aplikueshëm;
- Auditimi i planeve investive dhe financiare të NP, planit vjetor të biznesit dhe buxhetit vjetor;
- Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit dhe deklaratat e fitimeve dhe humbjeve si dhe deklaratat financiare që kërkohen me ligj;
- Vlerësimi objektiv dhe shfrytëzimi efektiv i burimeve të NP si dhe dhënia e rekomandimeve adekuate për Komisionin e Auditimit;
- Verifikimi i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt i sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga NP, të gjitha Ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe t'i siguroj Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje apo sugjerime të cilat konsiderohen të nevojshme;
- Verifikimi i rregullt i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i NP, duke përfshirë dokumentacionin financiar mbahet në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me Ligjin dhe që projekt deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt;
- Analiza e sistemeve dhe proceseve të biznesit dhe kontrolleve të ndërlidhura me to;
- Raportimi i rregullt para Komisionit të Auditimit dhe përmbushja e çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga Komisioni i Auditimit;

**Paga:** Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

### Kushtet dhe kualifikimet e kërkua:

Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe po ashtu secili kandidatë duhet të përmbushë të gjitha kushtet e pavarësisht ashtu sikurse parashihet në nenin 17.2 (d), (f), (j), (k), (l) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

### Kushtet e përgjithshme:

- Të ketë përgatitje superiore-Fakulteti ekonomik, juridik, administratë publike, financa publike, 4 vjeçare ose me sistem Bolonjës 3+2;
- Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë si auditor apo punë menaxhuese;

### Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional, (njohuri të qasjeve moderne në planifikim dhe kontroll, njohuri të Ligjeve, Rregulloreve dhe Udhëzimeve Administrative të aplikueshme, shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale);
- Të jetë i/e certifikuar për auditim;
- Të ketë aftësi organizative;
- Të ketë njohuri të punës me kompjuter Micr. Word, Excel dhe Acces;
- Të mos jetë i/e dënuar ose nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj) dhe
- Njohja e gjuhës angleze është e preferuar.

### Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin,
- CV-në,
- Dëshminë e shkollimit,
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Certifikatën për Auditor të Brendshëm,
- Referencat, si dhe certifikatat tjera profesionale,
- Letër Motivimin,
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj),
- Kopja e dokumentit të identifikimit.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen tek Sekretaria e Kompanisë në zarf të mbyllur me shënim: Për pozitën: Auditor i Brendshëm i KRM "Çabrati" Sh.A.

Vlerësimi formal i kandidatëve dhe intervista do të bëhet në një kohë optimale pas përfundimit të afatit për aplikim. Komisioni i Auditimit e mban të drejtën e formimit të listës së ngushtë me aplikantët.

Konkursi është i hapur nga data **04 shkurt - 05 mars 2021, ora 16:00.**



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE  
REGIONAL WASTE COMPANY  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel. +381(0)390/321 588  
+381(0)390/324 034  
www.cabrati.com  
e-mail. info@cabrati.com  
Gjakovë - Gjakova

**K.R.M. "ÇABRATI"**

U skladu sa odredbama člana 21., člana 25. stav 25.2 tačka h) Zakona br. 03 / L-087 o preduzećima u javnom vlasništvu („Službeni list Republike Kosovo”, br. 31/15. Jun 2008), odnosno član 13 Zakona br. 04 / L-111 o izmeni i dopuni zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima (Službeni list Republike Kosovo "br. 13/30. Maj 2012. godine), Komisija za reviziju Regionalne kompanije za otpad,, Cabrati "AD, u Đakovici, na sastanku održanom: **02.02.2021**, doneo odluku Br. 167, s kojim objavljenju:

## KONKURS

**Pozicija:** Unutrašnji revizor.  
**Odgovara:** Komisiji za Reviziju.  
**Mesto:** akovica.

### Zadaci i Odgovornosti.

- Rukovođenje, upravljanje i unutrašnju organizaciju Kancelarije za reviziju;
- Sastavljanje revizorskih postupaka, odnosno plana interne revizije za sve transakcije PJ, u skladu sa ciljevima unutrašnje kontrole, politikama i procedurama JP, na osnovu važećeg zakona;
- Revizija investicionih i finansijskih planova PJ, godišnjeg poslovnog plana i godišnjeg budeta;
- Revizija godišnjeg bilansa stanja i bilansa uspeha, kao i finansijskih izveštaja propisanih zakonom;
- Objektivna procena i efikasna upotreba resursa PJ, kao i davanje adekvatnih preporuka Odboru za reviziju;
- Verifikacija adekvatnosti i pravilnog funkcionisanja sistema i postupaka koji imaju za cilj da garantuju sprovođenje od strane PJ svih zakona primenljivih na Kosovu tokom vršenja njegove delatnosti i da pruže Komisiji za Reviziju sve primedbe ili sugestije koji se smatraju neophodnim;
- Redovna verifikacija adekvatnosti i pravilnog funkcionisanja sistema i procedura kojima je cilj osigurati da se knjige i dokumentacija JP, uključujući finansijsku dokumentaciju, vode u skladu sa računovodstvenim standardima i Zakonom i da projekti izveštaji finansijski godišnji koji se redovno pripremaju;
- Analiza poslovnih sistema i procesa i srodnih kontrola;
- Redovno izveštavanje od strane Komisije za reviziju i ispunjavanje bilo kojih drugih dužnosti koje mu dodeli odbor za reviziju;

**Plata:** U skladu sa politikom nadoknade koju je odobrio Odbor direktora,

### Potrebnosti uslovi i kvalifikacije:

Komisija za reviziju želi da se osigura da su svi potencijalni kandidati osobe priznatog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove prema članu 17.1 Zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima dopunjen i dopunjen Zakonom br. 04 / L-111 o izmenama i dopunama zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima, a takođe i svaki kandidat mora da ispuni sve uslove nezavisnosti predviđene članom 17.2 (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima dopunjen i dopunjen Zakonom br. 04 / L-111 o izmenama i dopunama zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima.

### Opšti uslovi:

- Da ima superiono obrazovanje- Falutet ekonomije, prava, javne uprave, javnih finansija, 4 /četiri/godine ili 3+2 Bolonskog sistema;
- Da ima najmanje pet (5) godine profesionalnog radnog iskustva u oblastima interne revizije, ili menadjalne poslovanja;

### Posebni uslovi:

- Da poseduje visok morlnog integritete (Poznavanje savremenih pristupa planiranju i kontroli, poznavanje važećih zakona, propisa i administrativnih uputstava, komunikacione veštine, planiranje rada i liderske sposobnosti revizorskih aktivnosti, i istraživačke, analitičke, ocenjivačke veštine i formulisanje preporuka i profesionalni saveti;
- Sertifikat internog revizora;
- Organizacione veštine;
- Računarske veštine u softveru, Micr. Vord, Ekcel i Acces;
- Da nije pod istragom (ne starija od 3 meseca), i
- Poželjno je znanje engleskog jezika .

### Kandidat mora dostaviti sledeće dokaze:

- Aplikaciju,
- CV,
- Dokaz o obrazovanju,
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Sertifikat internog revizora,
- Reference, kao i druge profesionalne potvrde,
- Motivaciono pismo,
- Potvrda da nije pod istragom (ne starija od 3 meseca)
- Kopija ličnog dokumenta,

Kompletni dokumenti se dostavljaju Sekretarijatu Kompanije u zatvorenoj koverti sa napomenom: Za radno mesto: Interni revizor RKO "Čabrat" AD. Formalna evaluacija kandidata i intervju obaviće se u optimalno vreme nakon isteka roka za prijavu. Komisija za reviziju zadržava pravo da formira uži spisak kandidata.

Konkurs je otvoren **04 Februar 2021 do 05 Mart 2021. u 16:00.**

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “DEA-D” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810086018, Gjakovë, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “DEA-D” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 810086018, Gjakovo ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “DEA-D” L.L.C. has come to the decision to quit its nr: 810086018, Gjakovë the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



### Shkolla e Mesme e Profesionale “ Ymer Prizreni “ Prizren

Kosovë 20000 Prizren rr.Bajram Curri p.n  
Nr.tel.038/20035377  
e-mail:mgavazaj@hotmail.com

Nr.protokoli-55/2021



Në bazë të Rregullorës nr.01/2017,datë 02.02.2017, Ligjit NR.04/L-143, nenit 12 për Arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës , Drejtori i Shkollës së Mesme Ekonomike “Ymer Prizreni” në Prizren, vendos për pranimin e nxënësve në arsimin për të rritur dhe me këtë rast publikon këtë:

### KONKURS

#### EKONOMI

1.Kontabilitet..... 1 paralel 24 nxënës

2.Tregti me pakicë e shumicë..... 1 paralel 24 nxënës

#### HOTELERI

1.Asistent restoranti.....1 paralel 24 nxënës

#### JURIDIK

1.Admin dhe shërbimet e zyrës..... 1 paralel 24 nxënës

#### TEKNOLOGJI USHQIMORE

1.Teknologji ushqimore..... 1 paralel 24 nxënës

#### Kushtet:

Dokumentacioni (dëftesa e shkollimit paraprak,certifikata e lindjes, dhe letërnjoftimi i fotokopjuar).

Pagesa bëhet sipas rregullores së MASHT-it Nr.11/2011 Dt.:30.12.2011 dhe Rregullores për tarifa,taksa,ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale nr.01/11.

1. Për regjistrimin e vitit për një klasë: 100 €
2. Praktika profesionale 50 €
3. Lënda me shkrim dhe me gojë 10 €
4. Lënda me gojë 8€
5. Për provim përfundimtar (certifikatë): 30€
6. Për diplomë(përfundimi i shkollimit): 50€
7. Provime diferenciale 10€

#### Vijueshmëria në mësim

Kandidatët e pranuar janë të obliguar që t'i ndjekin 18 javë mësimi nëse klasa e profilit përkatës numëron mbi 15 nxënës, dhe në fund t'i nënshtrohen testit vlerësues në të gjitha lëndët e parapara për arsimin për të rritur.

Për klasë ku numri i nxënësve është nën 15 nxënës, organizohet mësimi konsultativ.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në gazetë.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Zyla Mehemti shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Azem Bejta".

► Gezim Kalludra shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani".

► Ferat Ferati shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Migjeni"

► Agron Hasha shpall të pavlefshme dëftesën e klasës se 9-te te shkollës fillore "Azem Bejta".

► Besarta Sylejmani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Shemsi Ahmeti".

► Arjanit Januzi shpall të pavlefshme diplomën e SHMLE " Hasan Prishtina".

► Njomza Kotorri shpale të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shmlm "Dr. Xheladin Deda".

► Blerina Haxha shpall të pavlefshme dëftesën I,II të Shmlt "Arkitekt Sinani".

► Muhamet Hasani shpall të pavlefshme diplomën e SHMLE "Hasan Prishtina".

► Shkelzen Pllana shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 71224783.

► Nazlie jashari B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit nr. identifikues 810561953 dhe nrb. 70900793.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

